



GRUPI **GRETA**
I EKSPERTËVE PËR VEPRIM
KUNDËR TRAFIKIMIT ME
QENIE NJERËZORE

RAPORTI

PËR ZBATIMIN E KONVENTËS
SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR
VEPRIM KUNDËR TRAFIKIMIT
ME QENIE NJERËZORE NGA
ANA E "ISH REPUBLIKËS
JUGOSLLAVE E MAQEDONISË"

GRETA(2017)39

**RAUNDI I DYTË
I VLERËSIMIT**

I miratuar më 24 nëntor 2017

I publikuar më 21 shkurt 2018

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



GRUPI **GRETA**

I EKSPERTËVE PËR

VEPRIM KUNDËR

TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE

GRETA(2017)39

**Raporti për zbatimin e
Konventës së Këshillit të Evropës
për Veprim kundër Trafikimit me Qenie
Njerëzore nga ana e “Ish Republikës
Jugosllave të Maqedonisë”**

RAUNDI I DYTË I VLERËSIMIT

I miratuar më 24 nëntor 2017

I publikuar më 21 shkurt 2018

**Raporti për zbatimin e
Konventës së Këshillit të Evropës
për Veprim kundër Trafikimit me Qenie
Njerëzore nga ana e “Ish Republikës
Jugosllave të Maqedonisë”**

RAUNDI I DYTË I VLERËSIMIT

I miratuar më 24 nëntor 2017

I publikuar më 21 shkurt 2018

Përkthim jozyrtar

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

© 2018 Këshilli Evropës, Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura. E licencuar sipas kushteve të BE-së

Asnjë pjesë e këtij Publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në asnjë formë dhe me asnjë mjet, elektronik (CD Rom, internet etj) ose mekanik duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo ndonjë formë tjetër arkivimi apo ripërdorimi, pa lejen me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasburg, Cedex ose publishing@coe.int).

Publikuar brenda projekti për "Parandalimin" dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore".

Printime, dizejm dhe lekturim:
Arcus, Shkup

Përmbajtja

Preambula	5
I. HYRJE	Error! Bookmark not defined.
II. Rrjedhat kryesore për zbatimin e Konventës nga ana e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë"	11
1. Trendë të reja në trafikimin me qenie njerëzore	11
2. Rrjedha të kornizës ligjore	12
3. Rrjedhja në kornizat institucionale	12
4. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit	15
5. Trajnimi i profesionistëve merit	16
6. Mbledhja e të dhënave dhe hulumtimi	18
III. Konstatime sipas neneve	21
1. Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore	21
a. Masa për ngritjen e vetëdijes së TQNJ (Neni 5)	21
b. Masa për parandalimin e TQNJ për shkak të eksploatimit për punë (Neni 5)	21
c. Masa për parandalimin e trafikimit me fëmijë (Neni 5)	23
ç. Iniciativa sociale, ekonomike dhe tjera për grupe të cenuar të TQNJ (Neni 5)	26
d. Masa për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore për marrje të organeve (Neni 5) ...	27
dh. Masa për frenimin e kërkesës (Neni 6)	28
e. Masa kufitare (Neni 7)	29
2. Masa për mbrojtje dhe avancim të të drejtave të viktimave, me garanci për barazi gjinore	30
a. Identifikimi i viktimave të TQNJ (Neni 10)	30
b. Masat për ndihmë (Neni 12)	32
c. Identifikimi dhe ndihma për fëmijët viktimë të TQNJ (Nenet 10 dhe 12) ...	Error! Bookmark not defined.
ç. Mbrojtja e jetës private (Neni 11)	37
d. Periudha e vendimit (Neni 13)	37
dh. Leja për qëndrim (Neni 14)	38
e. Dëshmëpërblimi dhe mjetet ligjore (Neni 15)	Error! Bookmark not defined.
f. Riatdhesimi dhe kthimi i viktimave (Neni 16)	40
3. E drejta penale materiale	41
a. Kriminalizimi i TQNJ (Neni 18)	Error! Bookmark not defined.
b. Kriminalizimi i përdorimit të shërbimeve nga viktimë (Neni 19)	43
c. Përgjegjësia e personit juridik (Neni 22)	43
ç. Mos dënimi i viktimave të TQNJ (Neni 26)	43
4. Hetimi, ndjekja dhe e drejta procesuale	44
a. Masa lidhur me sigurimin e hetimit efektiv (Nenet 1, 27 dhe 29)	44
b. Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave (Neni 28)	46
c. Juridiksioni (Neni 31)	47
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me shoqërinë qytetare	47

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

a. Bashkëpunimi ndërkombëtar (Nenet 32 dhe 33)	47
b. Bashkëpunimi me shoqërinë qytetare (Neni 35)	49
IV. Konkluzione	50
Lista e organeve shtetërore, organizata ndërqevritare, organizata joqeveritare dhe aktorë tjerë të shoqërisë qytetare me të cilët GRETA ka zhvilluar konsultime	Error!
Bookmark not defined.	
Komente nga Qeveria	Error! Bookmark not defined.

Preambula

Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore (GRETA) është themeluar në pajtim me Nenin 36 të Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Këshillit të Evropës ("Konventës") që ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2008. GRETA ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Konventës nga ana e palëve kontraktuese dhe të përpilojë raporte për vlerësimin e masave që secila prej palëve kontraktuese i ka ndërmarrë.

GRETA përbëhet prej 15 ekspertëve të pavarur dhe paanshëm me origjinë të ndryshme, që zgjidhen në bazë të përvojës së tyre profesionale në fushat që përshihen nga Konventa. Anëtarët e GRETA kanë mandat prej katër viteve, me të drejtë për ri-zgjedhje.

GRETA në mënyrë individuale i monitoron gjitha palët kontraktuese të Konventës në baza të barabarta. Në përputhje me Nenin 38, Paragrafit 1 të Konventës, GRETA vlerëson zbatimin e Konventës duke monitoruar një procedurë që përbëhet nga katër raunde. Në fillim të secilit raund, GRETA i zgjedh dispozitat konkrete mbi të cilat do të mbështesë procedurën për vlerësim dhe përcakton mënyrën më të përshtatshme për zbatimin e vlerësimit. Për secilin raund të vlerësimit GRETA përgatit një pyetësor që shërben si bazë për vlerësim dhe ua dërgon të gjitha palëve kontraktuese.

Raundi i parë i vlerësimeve ka filluar në shkurt 2010 dhe pyetësori për këtë raund iu ishte dërguar gjithë palëve të kontraktuara në përputhje me orarin që ka përcaktuar GRETA, dhe që ishte në përputhje me kohën e hyrjes në fuqi të Konventës për secilën prej palëve kontraktuese. GRETA ka organizuar edhe vizita kombëtare të gjithë palëve kontraktuese për të mbledhur informacione plotësuese dhe të zhvillojë takime të drejtpërdrejta me gjithë aktorët efektiv, si ato qeveritare ashtu edhe joqeveritare. Deri në fillim të vitit 2014, pjesa më e madhe e palëve kontraktuese vetëm më ishin të vlerësuar për herë të parë se vlerësimi ishte në rrjedhë, dhe gjatë kësaj numri i palëve kontraktuese të Konventës vazhdoi të rritet.

GRETA ka marrë vendimin që të fillojë me raundin e dytë të vlerësimit të Konventës më 15 maj 2014. Pas raundit të parë të monitorimit, me anë të së cilës ishte bërë kontroll i zbatimit të Konventës në secilën prej palëve kontraktuese, GRETA ka marrë vendimin që me raundin e ri të vlerësimit të merren në shqyrtim ligjvënia, politika dhe masat praktike për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore si dhe përndjekja e trafikuesve me qenie njerëzore. Miratim i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut dhe veprimi kundër trafikimit me qenie njerëzore mbetet përqendrimi i raundit të dytë të vlerësimit. Përveç kësaj, vëmendje do të kushtohet masave që ndërmerren për të zgjedhur këto trendë të reja në trafikim me qenie njerëzore dhe aspektin e cenimit të fëmijëve ndaj trafikimit me qenie njerëzore. Për raundin e dytë të vlerësimit, GRETA ka përgatitur një pyetësor që duhet të dërgohet gjithë palëve kontraktuese që kanë kaluar raundin e parë të vlerësimit, në përputhje me orarin e aprovuar nga GRETA.

Raportet e GRETA-s bazohen në informacionet e mbledhur nga burime të ndryshme dhe përmbajnë rekomandime që kanë për qëllim përforcimin e zbatimit të Konventës në palën përkatëse kontraktuese. Në rekomandimet e saja, GRETA ka miratuar përdorimin e tre foljeve të ndryshme – "kërkon", "konsideron" dhe "fton" - që janë në përputhje me nivelet e ndryshme të

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

urgjencës së veprës së rekomanduar me të cilën ligjvënia dhe/ose praktika e palës kontraktuese duhet të përputhet me Konventën. GRETA e përdor foljen "kërkon" kur do të vlerësojë që ligjvënia ose politika e vendit nuk është në përputhje me Konventën, ose kur do të konstatojë që ndonëse ka dispozita ligjore dhe masa tjera, ngec me zbatimin e ndonjë obligimi nga Konventa. Në situata tjera, GRETA "konsideron" që është e domosdoshme të bëhen përmirësime për të arritur përputhje të plotë me ndonjë obligim të Konventës. Duke "ftuar" vendin të vazhdojë përpjekjet për ndonjë fushë përkatëse, GRETA arrin konkluzionin që autoritetet vendore janë në rrugën e drejtë.

Në lidhje me procedurën e përgatitjes së raporteve, GRETA e shqyrton propozim-raportin për secilën palë kontraktuese gjatë një seance plenare. Me anë të procesit të dialogut konfidencial me Autoritetet Kombëtare jepet mundësi të sigurohen, në afat prej dy muajve, komente për propozim-raportin e GRETA-s në kuptim të dorëzimit të informacioneve plotësuese ose përmirësimit të gabimeve eventuale të fakteve. GRETA i merr parasysh këto komente para se të përgatisë raportin final. GRETA miraton raportin final në seancë plenare dhe e dërgon sërish palës kontraktuese, të cilën e fton të dorëzojë komente eventuale përfundimtare. Pas skadimit të afatit prej një muaj, raporti i GRETA-s, bashkë me komentet eventuale përfundimtare nga Autoritetet Kombëtare, publikohet dhe dorëzohet para Komitetit të palëve kontraktuese të Konventës.

I. HYRJJE

1. Vlerësimi i parë i zbatimit të Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Këshillit të Evropës (në tekstin e mëtutjeshëm "Konventa") nga ana e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" është zhvilluar në periudhën prej vitit 2012 deri më 2014. Pas marrjes së përgjigjeve nga pyetësi i parë i GRETA-s nga ana e autoriteteve kombëtare më 29 maj 2012, prej 20 deri 23 maj 2013 ishte organizuar një vizitë vlerësimi në vend. Propozim-raporti për "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" ishte shqyrtuar në mbledhjen e 18-të GRETA-s (4-8 nëntor 2013), ndërsa raporti përfundimtar ishte miratuar në mbledhjen e 19-të (17-21 mars 2014). Pas marrjes së komenteve nga Autoritetet Kombëtare, raporti përfundimtar i GRETA-s ishte miratuar më 17 qershor 2014.¹

2. Në raportin e vlerësimit, GRETA ka vërejtur që autoritetet e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" (në tekstin e mëtutjeshëm "Autoritetet Kombëtare") kanë marrë një pjesë të konsiderueshme të hapave ligjvënës dhe organizative për të parandaluar dhe shkatërruar trafikimin me qenie njerëzore (TQNJ). Megjithatë, GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet të ndërmarrin masa plotësuese me të cilat do të sigurohet veprimi kundër trafikimit me qenie njerëzore të bëhet më e gjerë, dhe veçanërisht të kushtojnë më tepër vëmendje masave parandaluese dhe mbrojtëse me të cilat do të preket cenueshmëria e fëmijëve ndaj trafikimit me qenie njerëzore. Gjithashtu, GRETA ka ftuar Autoritetet Kombëtare që më tepër të përforcojnë koordinimin mes organeve shtetërore dhe aktorëve të shoqërisë qytetare dhe të sigurohet që OJQ-ve t'ju sigurohen resurset e nevojshme financiare për të ndërmarrë aktivitete për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore. Përveç kësaj, GRETA ka kërkuar nga autoritetet të avancojnë identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe të sigurohet që gjitha masat për ndihmë të përcaktuar me ligj të garantohen edhe në praktikë. Ndonëse dispozita ishte e mirëseardhur me ligji kombëtar me të cilin periudha e vendimit bëhet më e gjatë nga 30 ditët minimale të parashikuar me Konventën, GRETA ka kërkuar nga Autoritetet Kombëtare që të sigurohet që kjo periudhë mos të kushtëzohet me bashkëpunimin e viktimës me organet policore. Më tutje, GRETA ka ftuar Autoritetet Kombëtare që të sigurojnë se viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në mënyrë sistematike të informohet për të drejtën dhe të përfitojnë nga e drejta dhe të marrin leje për qëndrim me mundësi për rinovim. GRETA gjithashtu ka theksuar që autoritetet duhet të sigurojnë qasje efektive në dëmshpërblim, përfshirë edhe prezantimin e Programit Shtetëror për Dëmshpërblim dhe të ndërmarrin masa ligjore me të cilat do të mundësohet mos dënim i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore për përfshirjen e tyre në aktivitete të paligjshme, me kusht që të kenë qenë të detyruar për atë. Përveç kësaj, GRETA ka konsideruar që duhet tërësisht të shfrytëzohen masat në dispozicion për mbrojtjen e viktimave gjatë kohës së hetimit, si para, gjatë dhe pas procedurës gjyqësore.

3. Në bazë të raportit të GRETA-s, më 7 korrik 2014 Komiteti i palëve kontraktuese të Konventës ka miratuar rekomandim për Autoritetet Kombëtare, dhe gjatë kësaj ka kërkuar të

¹Raporti për zbatimin e Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore i Këshillit të Evropës nga ana e "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", GRETA (2014) 12, mund të gjendet në: <http://rm.coe.int/1680631ee1>

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

parashirojnë raport për masat që do të ndërmerren për përputhjen e këtij rekomandimi deri më 7 korrik 2016.²Raporti i dorëzuar autoriteteve kombëtare ishte shqyrtuar në mbledhjen e 19-të të Komitetit të palëve kontraktuese (4 nëntor 2016).Komiteti i palëve kontraktuese vendosi të transmetojë këtë raport tek GRETA për të shqyrtuar dhe publikuar.³

4. Më 8 qershor 2016 GRETA filloi me raundin e dytë të vlerësimit të Konventës me "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" ashtu që autoriteteve kombëtare ju dërgoi një pyetësor për këtë raund.Afati për dorëzimin e përgjigjeve të pyetësorit ishte 8 nëntor 2016, datë të cilën Autoritetet Kombëtare e respektuan dhe dorëzuan përgjigjen e tyre.⁴

5. Për përgatitjen e këtij raporti GRETA ka përdorur përgjigjet e autoriteteve kombëtare nga pyetësori, raportin të përmendur më lartë të dorëzuar nga ana e tyre deri tek Komiteti i palëve kontraktuese, si dhe informacionet e fituara nga shoqëria qytetare.Vizita e vlerësimit të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" u zhvillua prej 20 deri më 23 shkurt 2017 për të zhvilluar takime me autoritetet përkatëse dhe aktorët joqeveritar, të mblidhen informacione plotësuese dhe të shqyrtohet zbatimi praktik i masave të miratuara.Vizita ishte zhvilluar në përbërjen më poshtë:

- Z.Rishard Pjotrovic, anëtar i GRETA;
- Z-nja. Alina Brashoveanu, anëtare e GRETA;
- Z-nja. Ursulla Shtiker nga Sekretariati i Konventës.

6. Gjatë kohës së vizitës së delegacionit të GRETA, ata u takuan me z-nj. Sanja Dimitrievska, Koordinatore Kombëtare për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionin e Paligjshëm dhe Sekretarin Shtetëror pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, z.Aleksandar Todosiev, Njoftuesin Kombëtar për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionin e Paligjshëm dhe Udhëheqësin e Sektorit për Bashkëpunim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe punëtorë zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Prokurorisë Publike, Gjykatës Themelore Shkupi 1 dhe Avokatin e Popullit.Delegacioni gjithashtu ka realizuar takime edhe me përfaqësues të Komisioneve Lokale për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migracion të Paligjshëm nga Manastiri, Shtipi, Velesi dhe Prilepi.

7. Takime të veçanta ishte zhvilluar me përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ), avokatë të specializuar për dhënien e ndihmës viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe përfaqësues zyrtar të zyrave lokale të Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OBSE), Komisaratin e Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR), Fondin e fëmijëve të Kombeve të Bashkuara (UNICEF) dhe Qendrën Ndërkombëtare për Zhvillim të Politikave të Migracionit (ICMPD).

8. Gjatë vizitës së delegacionit, GRETA ka vizituar edhe Qendrën Pranuese Shtetërore për Viktima të Trafikimit me Qenie Njerëzore, Qendrën Pranuese për Viktima të Huaj të Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migrantë të Paligjshëm, Qendra Ditore për Fëmijë të Rrugës dhe Shtëpia e Sigurt për Kategori të Cenuar të Migrantëve dhe Azilkerkuesve, të gjitha me seli në Shkup.

9. Lista e autoriteteve kombëtare, OJQ-ve dhe organizatave tjera me të cilat delegacioni ishte konsultuar është dhënë në Aneksin e këtij Raporti.GRETA shpreh falënderimin për informacionet që i kanë siguruar.

10. GRETA dëshiron të theksojë edhe bashkëpunimin që ka hasur nga Autoritetet Kombëtare,

²Rekomandimi CP(2014)13 për zbatimin e Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore i Këshillit të Evropës nga ana e "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", miratuar në mbledhjen e 14-të të Komitetit të Palëve të Kontraktuar më 7 korrik 2014, mund të gjendet në: <http://rm.coe.int/1680631ede>


³Raporti i dorëzuar nga autoritetet kombëtare për masat e ndërmarra për përputhje me Rekomandimin CP(2014)13 për zbatimin e Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Komitetit të Palëve Kontraktuese, mund të gjendet në: <http://rm.coe.int/16806c0639>

⁴Përgjigje nga autoritetet kombëtare të Pyetësorit për Vlerësimi e zbatimit të Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Këshillit të Evropës nga ana e palëve kontraktuese, raundi i dytë i vlerësimit, mund të gjendet në: <http://rm.coe.int/greta-2017-6-rq2-mkd/168078a4f2>

dhe veçanërisht kontakt personin për lidhje me GRETA-n që ishte emëruar, z-një. Svetlana Vllahović Dimanovska, Zëvendës-Koordinatori Kombëtar për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm.

11. Propozim versioni i këtij raporti ishte miratuar nga GRETA në mbledhjen e 29-të (3-7 korrik 2017) dhe ishte dorëzuar pranë autoriteteve kombëtare për komente më 31 korrik 2017. Komentet e autoriteteve ishin fituar më 16 tetor 2017 dhe ishin marrë parasysh nga ana e GRETA-s gjatë miratimit të raportit përfundimtar në mbledhjen e 30-të (20-24 nëntor 2017). Në raport janë përfshirë gjendja aktuale deri më 24 nëntor 2017; ndryshimet pas kësaj date nuk janë marrë parasysh në analizën dhe konkluzionet që vijnë. Në pjesën e konkluzioneve është dhënë një rezymë e përparimit të arritur pas raportit të parë, çështjet për të cilat duhet të veprohet dhe fusha tjera që ka nevojë për veprim të mëtutjeshëm (shikoni faqet 46-52).

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



II.Rrjedhat kryesore për zbatimin e Konventës nga ana e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë"

1. Trende të reja në trafikimin me qenie njerëzore

12. "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" edhe më tutje mbetet shteti i origjinës, tranzitimit dhe destinacionit të viktimave të TQNJ-së. Sipas të dhënave statistikore të dorëzuar nga Autoritetet Kombëtare, 33 viktima të TQNJ-së kanë qenë të identifikuar në mënyrë formale në periudhën prej 2013 deri më 2016, prej të cilëve 21 kanë qenë fëmijë (në vitin 2013): 6 të rritur dhe 9 fëmijë viktima; në vitin 2014: 2 të rritur dhe 6 fëmijë viktima; në vitin 2015: 1 i rritur dhe 3 fëmijë viktima; në vitin 2016: 3 të rritur dhe 3 fëmijë viktima). Përveç një, të gjitha viktimat kanë qenë gra. Rreth gjysma e viktimave të identifikuara kanë qenë shtetas të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" që kanë qenë të trafikuar tej kufijve (që vendet kryesore të destinacionit kanë qenë Franca, Zvicra, Kroacia dhe Italia) ose në kufijtë e vendit. Prej viktimave, 15 kanë qenë për trafikim të brendshëm të qenieve njerëzore. Viktimat e huaja kanë ardhur nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Kosova*, si dhe Rumania. Forma kryesore e eksploatimit ka qenë ajo seksuale, pas së cilës, kanë qenë për trafikim të qenieve njerëzore për shkak të detyrimit me forcë për martesë (10), punë të detyruar me forcë (3), lëmshë (1), ose kombinim të më tepër formave të eksploatimit.

13. Më tutje, sipas të dhënave të siguruar nga Autoritetet Kombëtare, në periudhën 2013-2016 ka pasur 298 viktima potenciale të TQNJ (në vitin 2013: 82; në vitin 2014: 83, prej të cilëve 66 kanë qenë fëmijë; në vitin 2015: 11; në vitin 2016: 83, prej të cilëve 44 kanë qenë fëmijë; në vitin 2017: 12 të rritur). Më tepër për dallimin e dukshëm mes viktimave potenciale dhe viktimat formale të identifikuara, shikoni paragrafin 102.

14. Prej viti në vit ishte vërejtur një rritje e madhe e numrit të refugjatëve dhe migrantëve që kanë kaluar nëpër "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" për shkak të pozitës strategjike nëpër rrugët e përfshirë nga rajonet me konflikte, kryesisht nga Lindja e Afërt, drejt Bashkimit Evropian (BE). Prej qershorit 2015 deri më mars 2016, një periudhë në të cilën lëvizjet e migrantëve kanë arritur kulmin e tyre, për 778.768 refugjatë dhe migrantë ishte raportuar që kanë kaluar nëpër vendin.⁵ Numri i të arriturve të rinj, që kryesisht kanë ardhur nga Greqia, ka arritur më 5.000 në ditë. Në mars të vitit 2016 kufiri me Greqinë ishte mbyllur për hyrje të reja. Ndonëse ka pasur mbyllje formale, ishte vazhduar me lëvizjet e parregullta, me çfarë personat që kanë kaluar transit janë bërë më të prekshëm ndaj eksploatimit. Sfidat e imponuara me arritjen e madhe të refugjatëve dhe migrantëve i kanë rishpërndarë resurset nga autoritetet përgjegjëse për zbulim dhe hetim të rasteve për TQNJ (shikoni paragrafin 155). Sipas autoriteteve kombëtare, në vitin 2015 ishin zbuluar dy fëmijë të pashoqëruar nga Siria për të cilët ishte supozuar që janë viktima të trafikimit me qenie njerëzore mes migrantëve që kanë kaluar transit nëpër "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", ndërsa në mesin e migrantëve në vitin 2016 ishin zbuluar 35 viktima të supozuar të TQNJ (17 të rritur dhe 18 fëmijë). Megjithatë, në mesin e azilkërkuesve dhe migrantëve nuk kanë qenë formalisht të identifikuara viktima të trafikimit me qenie njerëzore.

15. GREТА ka shënuar që vëllimi i vërtetë i trafikimit me qenie njerëzore në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" është më i lartë nga numrat e përmendur më lartë të viktimave formale

* Çdo referim të Kosovës, territorit të saj, institucionet ose popullatës, në këtë raport nënkuptohet në përpunje të plotë me Rezolucionin 1244 të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara dhe nuk paragjykon statusin e Kosovës.

⁵UNHCR, Plani Rajonal për përgjigje të nevojave të refugjatëve dhe migrantëve nga rruga nëpër Evropë, Mesdheun Lindor dhe Ballkanin Perëndimor, janar-dhjetor 2016, f 73.

të identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore, dhe ajo ishte konfirmuar edhe nga ana e personave zyrtar, përfaqësuesve të shoqërisë qytetare dhe organizatave ndërkombëtare të cilat kanë zhvilluar takime gjatë vizitës së rëndësishme të dytë të vlerësimit të GRETA.

2. Rrjedha të kornizës ligjore

16. Në vitin 2015, Neni 418-d (trafikimi me fëmijë) nga Kodi Penal (KP) ishte ndryshuar në mënyrë që format e eksploatimit të përfshirë edhe lëmshën e detyruar dhe eksploatimin për shkak të aktiviteteve të ndaluar me ligj.⁶Përveç kësaj, dënimet për trafikim me fëmijë ishin rritur (shikon paragrafin 145). Në kohën e njëjtë, Qeveria ka fshirë Nenin 191-a nga KP për prostitucion fëmijëror.

17. Në rrjedhë është miratimi i Ligjit për të Huaj, ndërsa Autoritetet Kombëtare kanë paralajmëruar që me këtë ligj do të mundësohet që perioda e vendimmarrjes dhe rinovimit të lejes për qëndrim të mos kushtëzohen me bashkëpunimin e viktimës me autoritetet përgjegjës për hetim ose për procedurë penale. Propozimi ishte dërguar deri tek Komisioni Evropian për të marrë mendim. Pasi që të merret mendimi, Ministria e Punëve të Brendshme do të fillojë me procedurë për miratimin e ligjit. **GRETA dëshiron të njoftohet për miratimin e ligjit të ri Ligjin për të Huaj.**

18. Rrjedhat e përmendura lartë janë shqyrtuar në detaje në pjesët e mëposhtme të këtij raporti (shikoni paragrafin 145-147).

3. Rrjedhja në kornizat institucionale

19. Siç ishte shënuar në raportin e parë të GRETA-s, Komisioni Kombëtar për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm (në tekstin e mëtejshëm "Komisioni Kombëtar") është një trup koordinues mes resorëve me përgjegjësi të zbatimit, koordinimit, monitorimit dhe analizimit të politikës qeveritare për pengimin e TQNJ dhe migracionit të paligjshëm.⁷Nga vlerësimi i parë i GRETA-s, Komisioni Kombëtar është zgjeruar për gjashtë anëtarë: katër anëtarë nga Ministria e Punëve të Brendshme, një anëtar nga Agjencia e Punësimit dhe një anëtar nga Inspektorati Shtetëror i Punës.⁸GRETA e përshëndet zgjerimin e Komisionit Kombëtar, dhe veçanërisht përfshirjen e Inspektoratit Shtetëror të Punës. Siç njoftuan Autoritetet Kombëtare, Komisioni Kombëtar edhe më tutje takohet së paku një herë në çdo tre muaj. Vendimet e Komisionit

⁶Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal, Gazeta Zyrtare Nr. 226 të 25 dhjetorit 2015.

⁷V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 21-23.

⁸Komisioni Kombëtar përbëhet nga përfaqësuesit vijuese të ministrive dhe institucioneve publike: Koordinatori Kombëtar për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm, Zëvendës-Koordinatori Kombëtar për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm, Sekretari i Komisionit Kombëtar, gjykatës nga Gjykata Themelore Shkupi 1, prokuror nga Prokuroria Themelore Publike, nëpunës të lartë policor nga Ministria e Punëve të Brendshme, persona zyrtar i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Qendra për Trajnim pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtoria Doganore, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë dhe Byrosë për Zhvillim të Arsimit (shikoni Raporti i Parë, paragrafi 21).

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Kombëtar i zbaton Sekretariati i Komisionit Kombëtar, që në një vend do të mbledhen përfaqësues të shoqërisë qytetare, organizata ndërqeveritare, donatorë ndërkombëtar dhe persona ekspert nga institucionet qeveritare. Sekretariati punon në baza vullnetare. Sekretariati aktual është emëruar në vitin 2016.⁹

20. Koordinator i ri Kombëtar, që udhëheq me punën e Komisionit Kombëtar, ka qenë i emëruar në vitin 2016.¹⁰ Ngjashëm me paraardhësin, edhe ajo është Sekretare Shtetërore e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në raportin e parë të vlerësimit, GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet të prezantojnë një post të posaçëm Koordinator Kombëtar që do të mbështetet nga zyra përgjegjëse, që do ti mundësojë këtij trupi në mënyrë efektive të zbatojë mandatin përkatës. Autoritetet Kombëtare kanë deklaruar që Plani Kombëtar i Veprimit për zbatim të Strategjisë për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm për periudhën 2017-2020 (shikoni paragrafin 29) parashikon përfundim të kapaciteteve të strukturave koordinuese (Komisioni Kombëtar) në mënyrë që do të zgjidhet kuadro profesionale që do të punojë në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar. Kjo detyrë është përcaktuar për vitin 2017-2018. **GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të hapin një post të posaçëm Koordinator Kombëtar, që do të ketë në dispozicion resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, për të mundur në mënyrë efektive të zbatojë detyrat e mandatit përkatës.**

21. Mekanizmi Kombëtar për Referim (MNR) i viktimave të TQNJ, që ishte institucionalizuar me hapjen e Zyrës së MNR pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në vitin 2009¹¹ dhe më tutje është përgjegjës për koordinimin e referimit të viktimave të identifikuara drejt ndihmës përkatëse, akomodimit, mbrojtjes, re-integrimit dhe ri-shoqërimit.

22. Nën-grupi për luftë kundër trafikimit me fëmijë i themeluar në vitin 2003 edhe më tutje funksionon si trup pune në kuadër të Komisionit Kombëtar. Me Nën-Grupin udhëheq përfaqësues i Zyrës së MNR-së, ndërsa pjesëmarrës tjerë janë përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Njësia për Pengimin e TQNJ dhe Kontrabandës së Migrantëve dhe Sektori për Punë Kufitare dhe Migracion), ICMPD, IOM, Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), UNICEF, Ambasada e SHBA-ve në Shkup dhe OJQ-të "Otvorena Porta / La Strada", "Za Sreknio Detstvo" dhe "Ednakov Pristap", si dhe zëvendës-avokati i popullit në cilësinë e monitoruesit të jashtëm.

23. Njoftuesi i ri kombëtar për Luftë kundër TQNJ dhe Migracion të Paligjshëm, që ndryshe është i punësuar si Udhëheqës i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishte emëruar në vitin 2016. Si pjesë e përgjegjësisë, Njoftuesi Kombëtar publikon raporte vjetore për gjendjen e trafikimit me qenie njerëzore në vend, përfshirë edhe të dhëna statistikore dhe informacione për trendët. Në raportin e parë të vlerësimit, GRETA ka ftuar Autoritetet Kombëtare të prezantojnë postë të pavarur pune de jure të Njoftuesit Kombëtar, me mandat të monitorojë aktivitetet e institucioneve shtetërore në kuptim të pengimit të trafikimit me qenie njerëzore. Autoritetet Kombëtare kanë deklaruar që Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm për periudhën 2017-2020 parashikojnë disa aktivitete lidhur me funksionin e Njoftuesit Kombëtar, përfshirë edhe zbatimin e analizës krahasuese të praktikave të njoftimit kombëtar në BE dhe përcaktimit të modelit kombëtar që do të kontribuojë për përfundimin e pozitës së Njoftuesit Kombëtar. GRETA dëshiron të theksojë që në përputhje me Nenin 29 të Konventës bëhet një dallim i qartë mes Koordinimit Kombëtar dhe Njoftuesit Kombëtar. Sipas mendimit të GRETA-s, dallimi kryesor i mekanizmave të njoftuesve kombëtar, në kuptim të Nenit 29, paragrafit 4 të Konventës¹², duhet të jetë aftësia që në mënyrë kritike të monitorohen përpjekjet dhe efektiviteti i gjithë institucioneve shtetërore, përfshirë edhe koordinatorët kombëtar, dhe për këtë qëllim duhet të jetë në komunikim të vazhdueshëm me shoqërinë qytetare, opinionin shkencor dhe palë tjera të përfshira. Për të ndryshuar qasjen e

⁹Rezolucioni Nr. 42-860/1.

¹⁰Gazeta Zyrtare Nr. 163/2016.

¹¹V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 30.

¹²"Secila palë kontraktuese do të merr për detyrë të emërojë Njoftues Kombëtar ose mekanizma tjerë për monitorimin e aktiviteteve për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore prej institucioneve shtetërore dhe zbatimin e kërkesave të ligjeve kombëtare."

bazuar në të drejtat e njeriut në kuptim të politikave për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore, për të cilën punon edhe Konventa, duhet monitorim dhe vlerësim përkatës. Ndarja strukturore e monitorimit nga funksionet ekzekutive shkon në dobi të vlerësimit objektiv të zbatimit të ligjvënies, politikës dhe aktivitetet për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore, zbulimi i mungesave dhe përpilimi i rekomandimeve të plota për ligjvënien dhe politikën.¹³ **GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të bazohen në Njoftues Kombëtar të pavarur ose të emërojnë mekanizëm tjetër si subjekt të pavarur organizativ në drejtim të sigurimit të monitorimit efektiv të aktiviteteve të institucioneve shtetërore në lidhje me pengimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe dhënien e rekomandimeve për palët dhe institucionet e interesuara.**

24. Nga vizita e parë, përveç dy Komisioneve Lokale për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm që janë vetëm më aktive në qytetet e Manastirit dhe Shtipit¹⁴, në vitin 2014 janë hapur edhe Komisione Lokale në Gjevgjeli, Prilep dhe Veles. GRETA ishte informuar që edhe tre Komisione Lokale të reja duhet të themelohen, me atë që në fund do të bëhen tetë gjithsej. Autoritetet Kombëtare kanë deklaruar që pas përfundimit të procesit zgjedhor do të bëhet një analizë e nevojave për zgjerimin e këtyre komisioneve dhe/ose themelimit të komisioneve të reja. **GRETA dëshiron të njoftohet për veprimin me Komisionet e reja Lokale për Luftë kundër TQNJ.**

25. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale edhe më tutje është përgjegjëse për udhëheqje me Qendrën Shtetërore (Strehimores) për viktime të TQNJ (shikoni paragrafin 108). Përveç kësaj, ministria e bashkë-financon edhe Shtëpinë e Sigurt të hapur nga ana e OJQ-së ndërkombëtare "Shërbimi Jezuit për Refugjatë" në qershor 2015 për kategoritë e cenuara të migrantëve dhe azilkërkuesve (shikoni paragrafët 78 dhe 109).


26. Avokati i Popullit është themeluar me Kushtetutën e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" dhe për herë të parë ishte zgjedhur në vitin 1997. Gjithsej 72 persona punojnë në Zyrën e Avokatit të Popullit në Shkup edhe në zyrat rajonale. Përveç fushave tjera të punës, Avokati i Popullit e plotëson edhe funksionin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit në përputhje me Protokollin Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës së OKB-së (OPKAT) dhe monitoron gjendjen e vendeve ku personat largohen nga liria, përfshirë edhe Qendrat e Pranimit për Migrantë, në të cilën përqendrohet në mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenuara, përfshirë edhe fëmijët e pashoqëruar. GRETA ishte informuar që Avokati i Popullit nuk merr pjesë në takimet e Komisionit kombëtar dhe ata nuk ishin të konsultuar gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2017-2020. Komisioni Kombëtar planifikon të bëjë revizion të anëtarësimit dhe sipas mundësisë të përfshijë përfaqësues të Zyrës së Avokatit të Popullit. **GRETA i fton Autoritetet Kombëtare që të angazhojnë Zyrën e Avokatit të Popullit në zbatimin e aktiviteteve për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe në hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit në përmasa kombëtare.**

27. OJQ-të edhe më tutje luajnë rolin thelbësor të veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore, me anë të pjesëmarrjes në Sekretariatit e Komisionit Kombëtar, zbatim të projekteve

¹³Në këtë kontekst, shikoni edhe Raporti Përmbledhës nga Mbledhja Konsultuese për Përforcimin e Partneriteteve me Njoftuesit Kombëtar për Trafikim me Qenie Njerëzore dhe mekanizma ekuivalente që ishte organizuar nga Njoftuesi Special i OKB-së për trafikim me qenie njerëzore, veçanërisht gra dhe fëmijë, në Berlin, 23-24 maj 2013.

¹⁴V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 26.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



me anë të punës së parandalimit dhe sigurimit të ndihmës për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore si dhe zbatimin e hulumtimeve (shikon paragrafët 50, 54, 56, 63-66, 108, 113 dhe 180).

4. Strategjia Kombëtare dhe Planit i Veprimit

28. Në vitin 2016, me mbështetje financiare të IOM-it, një ekspert i pavarur ka bërë vlerësimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Kombëtar për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm 2013-2016.¹⁵ Mes zbulimeve të tjera, vlerësimi ka bërë të ditur për nevojën e themelimit të një qasje sistematike në drejtim me të dhënat, si dhe të sigurohen strukturat e qëndrueshme të financimit. Më tutje, me anë të vlerësimit ishte vërejtur edhe mungesa e formularit të standardizuar për vlerësim të trajnimeve të zgjedhura dhe kriteret e shkruara për zgjedhje të trajnuesve. Autoritetet Kombëtare kanë konfirmuar që rezultatet e vlerësimit ishin marrë parasysh gjatë hartimit të Strategjisë së re Kombëtare dhe Planit të Veprimit të ri.

29. Gjatë kohës së vlerësimit të dytë të GRETA-s, Strategjia e re Kombëtare dhe Planit i Veprimit të ri për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm për periudhën 2017-2020 ishin hartuar me mbështetjen e IOM-it. Këto dy dokumente ishin miratuar nga ana e Qeverisë më 22 mars 2017. Planit Kombëtar i Veprimit përmban masa në fushat e njëjta sikur edhe në planin e mëparshëm (kornizë për mbështetje, parandalim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe migrantëve, procedurë para-hetimore dhe ndjekje penale të TQNJ dhe kontrabandës së migrantëve), me plotësim të integritetit dhe kthimit vullnetar të viktimave trafikimit me qenie njerëzore dhe migrantë si fushë e re tematike. Një theks i posaçëm është vendosur mbi rritjen e kuptimit të lidhjes me TQNJ dhe migracionit, si dhe përmirësim të mekanizmave koordinuese. Aktivitetet e parashikuara me Planin e Veprimit do të financohen nga buxheti i Komisionit Kombëtar, nga buxhetet e ministrive resorë dhe institucionet kompetente, si dhe me anë të projekteve të financuara nga organizata ndërkombëtare. Megjithatë, Autoritetet Kombëtare nuk kanë bërë konkrete shumën e mjeteve të parashikuara për zbatimin e Planit të Veprimit. GRETA thekson që për zbatimin e Planit të Veprimit Kombëtar dhe Strategjisë 2017-2020 duhet patjetër të ndahen mjete nga buxheti. **Duke përkujtuar rekomandimin që ka dhënë në raportin e parë të vlerësimit, GRETA konsideron që autoritetet duhet të ndajnë mjete specifike nga buxheti i shtetit për veprim kundër TQNJ, me anë të konsultimit të gjithë aktorëve meritore, ndërsa duke pasqyruar nevojat e vërteta të një qasje të koordinuar dhe efektive të bazuar në të drejtat të njeriut për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore.**

30. Siç ishte theksuar në raportin e parë të GRETA-s, politika kombëtare për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore shpesh ndërlidhet me veprime kundër kontrabandës së migrantëve, që pasqyrohet edhe në titullin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit, si edhe në titujt e disa prej trupave që janë përgjegjës për dy dukuritë (p.sh. Komisioni Kombëtar për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm ose Njësisë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për Pengimin e TQNJ dhe Kontrabandës së Migrantëve).¹⁶ GRETA përkujton që ndonëse këto dy dukuri mund të jenë të ndërlidhur ndonjëherë, në kuptimin ligjor janë të ndarë dhe bëjnë pjesë në grupe të ndryshme të obligimeve nga marrëveshja. **GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të vazhdojnë me ngritjen e vetëdijes mes profesionistëve dhe në mes të opinionit të gjerë në lidhje me përcaktimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe për dallimet, por edhe lidhjet, mes trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës së migrantëve.**

31. Në bazë të Planit të Veprimit Kombëtar, pesë Komisionet Lokale për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm kanë miratuar planet e tyre lokale në mars 2017. Për shkak të faktit që

¹⁵Sunçica Dimitrijoska, Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, 2013-2016, maj 2016.

¹⁶Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 62.

buxhetet komunale për vitin 2017 ishin miratuar në fund të vitit paraprak, këto buxhete nuk kanë qenë të parashikuara mjetet për aktivitete të përcaktuara me planet e veprimit të Komisioneve Lokale; andaj, këto aktivitete është dashur të financohen nga OJQ në vitin 2017. Me buxhetet e reja për vitin 2018, do të përcaktohen mjete edhe për Komisionet Lokale. **GRETA konsideron që autoritetet duhet të përforcojnë punën e Komisioneve Lokale për Luftë kundër TQNJ, përfshirë edhe me anë të sigurimit të mjeteve specifike për aktivitete të tyre.**

5. Trajnimi i profesionistëve merit

32. Autoritetet Kombëtare veç më kanë theksuar më tepër masa për trajnim që do të mund të zbatohen gjatë periudhës së raportimit, që në masë të madhe do të financoheshin nga burime të jashtme financiare.¹⁷ Komisioni Kombëtar ka miratuar një Plan mes Resorëve për Trajnim 2016-2017 për palët e interesuara në nivelin qendror, rajonal dhe lokal.

33. Për shembull, si pjesë e Planit për Trajnim, dhe në bashkëpunim me IOM-in, ishin zhvilluar katër trajnime njëditore në tetor-nëntor 2016 për "Indikatorët e Identifikimit të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Rrjedhat e Përziera të Migracionit" që ishin hartuar në vitin 2016 për të përforcuar kapacitetet e palëve meritorë të interesuara për identifikimin e hershëm të viktimave potenciale dhe të supozuara të TQNJ (shikoni paragrafin 93). Gjithsej 160 pjesëmarrës nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Komisionet Lokale, OJQ, Kryqi i Kuq dhe Zyra e Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë në trajnimet. Më tutje, në bashkëpunim me UNHCR, Komisioni Kombëtar ka organizuar gjashtë trajnime dyditore në tetor-dhjetor 2016 për zbatimin e Procedurave Standarde Operative (PSO) për veprim me fëmijë të pashoqëruar dhe të ndarë (shikoni paragrafin 67) dhe PSO për veprim me kategori të cenuara të shtetasve të huaj (shikoni paragrafin 77). Ishin trajnuar gjithsej 120 përfaqësues të Komisionit Kombëtar, të organeve tjera përgjegjës në pushtet, nga organizatat ndërkombëtare, OJQ dhe Zyra e Avokatit të Popullit.

34. Në vitin 2016, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka zbatuar një punëtori për "Njohjen e Viktimave Potenciale të TQNJ mes Refugjatëve" për punëtorët social dhe përfaqësuesve të MKR, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup.

35. Në vitin 2015 ishin zbatuar një numër i madh i trajnimeve mes resorëve. Për shembull, me mbështetjen e GIY-it, ishin zhvilluar tre trajnime njëditore për indikatorët e identifikimit të viktimave të TQNJ për 75 nëpunës policor, punëtorë social dhe OJQ-në "Ednakov Pristap". Përveç kësaj, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka zbatuar trajnime dyditore për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimit të trafikimit me fëmijë, në bashkëpunim me Ministria e Punëve të Brendshme, Entin për Punë Sociale, OJQ "Otvorena Porta / La Strada" dhe GIY. Trajnimi ishte synuar për të punësuarit në shtëpitë për fëmijë dhe institucionet tjera publike në të cilat kujdesen fëmijët, ndërsa pjesëmarrësit ishin emëruar si persona për kontakt në institucionet e tyre. Më tutje, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka trajnuar

¹⁷Për më tepër detaje, shikoni përgjigjet e pyetjeve 6, 8 dhe 22 të Përgjigjeve të "Ish Republikës Jugosllav të Maqedonisë" për Pyetësin e GRETA për raundin e 2-të të vlerësimit, mund të gjendet në: <http://rm.coe.int/greta-2017-6-rq2-mkd/168078a4f2>

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

60 profesionistë në trajnim dyditor që është zhvilluar dhe ka përmbajtur edhe ushtrime praktike për zbulimi e viktimave në Qendrën e Pranimit për Azilkërkues dhe Qendrat Pranuese të Transitit në Tabanovcë dhe Vinojug.

36. Trajnimet për TQNJ ishin organizuar edhe në vitin 2015 nga ana e Misionit të OSBE-së në Shkup, në bashkëpunim me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj, për 17 avokatë dhe përfaqësues të shoqërisë qytetare që kanë siguruar ndihmë juridike falas për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore. Përveç kësaj, OJQ "Otvorena Porta / La Strada" kanë dhënë trajtime për studentët e juridikut për monitorimin e rasteve gjyqësore për TQNJ.

37. Më tutje, gjatë periudhës së raportimit janë zhvilluar edhe disa trajnime të specializuara për TQNJ për anëtarët e policisë kufitare.¹⁸Për shembull, IOM-i ka organizuar trajnim me titullin "Pengimi i TQNJ dhe kontrabanda e migrantëve" të cilën e kanë vizituar 180 policë kufitarë. IOM-i gjithashtu ka organizuar trajnim humanitar për drejtimin e kufijve me stafin e Qendrave Rajonale të Policisë Kufitare, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Qendrat Rajonale për Punë Sociale, Kryqi i Kuq, OJQ-të dhe aktorët ndërkombëtarë.

38. Përveç kësaj, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj dhe ON Zheni në shtator 2016 në Strugë kanë organizuar një trajnim dyditor për nëpunësit policor, punëtorët social dhe OJQ-të në temën e dimensionit gjinor të TQNJ.

39. Disa trajnime për TQNJ ishin organizuar për gjykatës dhe prokurorë gjatë periudhës së raportimit. Për shembull, Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik "Pavel Shatev" ka zhvilluar dy seminare për krim të organizuar me fokus mbi TQANJ dhe kontrabandës së migrantëve, që ishin të vizituar nga 45 gjykatës, prokurorë, avokatë, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe persona tjerë zyrtarë. Tryeza dyditore e rrumbullakët, e organizuar në vitin 2015 nga ana e Misionit të OSBE-së në Shkup, me titullin "Identifikimi dhe Ndjekja e Veprave Kriminale të TQNJ për Shkak të Eksploatimit të Punës" ishte dedikuar për 25 gjykatës, prokurorë dhe nëpunës policor. Përveç kësaj, OJQ "Otvorena Porta / La Strada" në vitin 2015 ka zbatuar një trajnim rajonal për gjykatës dhe prokurorë publik në temën e lehtësimin të dëmshpërblimit të viktimave të TQNJ.

40. Në kohën e vizitës së dytë të vlerësimit, GRETA ishte informuar që inspektorët e punës nuk kanë fituar trajnim për trafikim me qenie njerëzore gjatë periudhës së raportimit. Pas kësaj ishte filluar me zhvillimin e këtyre trajnimeve në kuadër të projektit "Parandalimi dhe pengimi i TQNJ në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", që ishte zbatuar si pjesë e kornizës programore të BE-së dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" (shikoni paragrafin 58). Më fillim ishte zhvilluar një trajnim dyditor për trajnerë më 19-20 tetor në Mavrovë, me pjesëmarrjen e 25 inspektorëve të punës. Qëllimi i trajnimit ishte të avancohen kapacitetet e inspektorëve të punës për kryerjen e inspektimeve pro aktive në drejtim të zbulimit të viktimave të mundshëm të trafikimit me qenie njerëzore, sigurimit të qasjes në ndihmë për viktimat, si dhe përforsim të bashkëpunimit mes resorëve të palëve meritorë të interesuar. Trajnimi i dytë i inspektorëve të punës në temën e TQNJ për shkak të eksploatimit të punës ishte zhvilluar më 1-2 nëntor 2017 në Berovë, me pjesëmarrjen e 25 inspektorëve të punës.

41. Stafi i vendosur në misionet diplomatike dhe konsullata të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" edhe më tutje merr trajnim prezantimi për TQNJ para se të niset jashtë vendit.

42. Plani Kombëtarë i Veprimit 2017-2020 parashikon aktivitete për trajnim të nëpunësve policor, prokurorëve publik, gjykatësve, inspektorëve të punës, punëtorëve shëndetësor, punëtorëve social, anëtarëve të Komisioneve Lokale, stafi i përfaqësive diplomatike dhe konsullore, mësimdhënës të arsimit të mesëm dhe të lartë, studentë, profesionistë që punojnë në institucionet për kujdesin social, avokatë, përfaqësues të mediave, anëtarë të Lidhjes së Sindikatave dhe Oda Ekonomike, familje që ushqejnë dhe kujdestarë ligjor.

43. **GRETA ka përshëndetur përpjekjet për trajnim të profesionistëve meritor në**

¹⁸Për më tepër detaje, shikoni përgjigjet e pyetjes 6 të Përgjigjeve të "Ish Republikës Jugosllav të Maqedonisë" për Pyetësorin e GRETA për raundin e 2-të të vlerësimit, mund të gjendet në:

temën e TQNJ dhe konsideron që këto përpjekje duhet në mënyrë sistematike të vazhdojnë dhe të përfordojnë, gjatë së cilës vëmendje të posaçme duhet kushtuar trajnimit të inspektorëve të punës, stafit mjekësor dhe profesionistë tjerë për të cilët ka mundësi që të vijnë në prekje me viktimat për trafikim me qenie njerëzore, përfshirë edhe fëmijët. Më tutje, GRETA i fton Autoritetet Kombëtare që në intervale të rregullta të vlerësojnë rëndësinë, efektin dhe shtrirjen e aktiviteteve për trajnim.

6. Mbledhja e të dhënave dhe hulumtimi

44. Në raportin e parë të vlerësimit, GRETA ka konsideruar që për nevojat e miratimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore, Autoritetet Kombëtare duhet të hartojnë dhe mirëmbajnë një sistem të gjerë dhe të përputhur statistikor për TQNJ ashtu që do të mblidhen të dhëna të besueshme statistikore të gjithë aktorëve kryesor që do të mundësojnë shpërndarjen e tyre (në lidhje me gjininë, moshën, llojin e eksploatimit, vendi i origjinës dhe/ose destinacioni).

45. Raportuesi kombëtar është personi kombëtar për kontakt në lidhje me grumbullimin e të dhënave për TQNJ me palët meritorë të interesuara. Ende është në aprovim të identifikimit të viktimave të TQNJ (me titullin "Formulari për Monitorim të Punës për Rast sipas Viktimës") që në vitin 2009 ka miratuar Komisioni Kombëtar për të mbledhur informacione nga gjithë organet e përfshira me PSO për veprim me viktimat e TQNJ.¹⁹

46. Të dhënat statistikore që i sigurojnë Autoritetet Kombëtare në lidhje me viktimat formale të identifikuar të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore të ndahen sipas vitit, numrit, gjinisë, moshës, shtetësisë, llojit të eksploatimit, nëse trafikimi ka qenë brenda vendit ose tej kufirit, si dhe trupi që ka identifikuar viktimën. Por, të dhënat statistikore për viktimat e supozuara (shikoni paragrafin 13) nuk ndahen sipas kategorive dhe vështirë mund të interpretohen. Përfaqësuesit e shoqërisë qytetare dhe organizatat ndërkombëtare me të cilat ishte zhvilluar takimi gjatë vizitës së dytë të vlerësimit ka shënuar që të dhënat shtetërore në dispozicion për trafikimin me qenie njerëzore nuk janë të besueshme dhe nuk janë të kompletuara, me çfarë pengohet analiza, krahasimi dhe llogaridhënia.²⁰ **Për nevojat e përgatitjes, monitorimi dhe vlerësimi i politikave për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përpilojnë dhe mirëmbajnë një sistem të gjerë dhe të përputhur statistikor për trafikim me qenie njerëzore me anë të mbledhjes së të dhënave të besueshme statistikore për viktimat e supozuara dhe identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore dhe masat për mbrojtje dhe avancim të të drejtave të tyre, si dhe për hulumtimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore. Statistikat për viktimat duhet të mblidhen nga gjithë aktorët kryesor dhe duhet të mundësohet shpërndarje e tyre sipas gjinisë, moshës, llojit të eksploatimit, shtetit të origjinës dhe/ose destinacionit. Kjo duhet të plotësohet me gjitha masat e nevojshme me të cilat do të sigurohet e drejta e subjekteve të të dhënave për të**

¹⁹V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 28.

²⁰Otvorena Porta / La Strada, Monitorimi dhe vlerësimi i ligjeve dhe politikave për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe zbatimi i tyre në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" në vitin 2014 dhe 2015, 2016, f. 52.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



mbrojtur të dhënat personale, përfshirë edhe kur OJQ-ve që punojnë me viktimat e trafikimit me qenie njerëzore do të kërkohet të jepen informacione për nevojat e bazës kombëtare me të dhëna.

47. GRETA rekomandon në raportin e parë të vlerësimit që për nevojat e krijimit të burimit të rëndësishëm të informacioneve për vlerësim dhe planifikim të masave për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore, autoritetet duhet të zbatojnë dhe mbështesin hulumtime të çështjeve lidhur me TQNJ, veçanërisht për trafikimin me qenie njerëzore për shkak të eksploatimit për punë, lëmshës me forcë dhe trafikimit me qenie njerëzore. Nga vlerësimi i parë i GRETA-s, organet shtetërore, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria qytetare kanë zbatuar disa projekte hulumtuese lidhur me TQNJ.

48. Në vitin 2014, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup dhe me kyçjen e sektorit qytetar, Komisioni Kombëtar ka zbatuar hulumtim empirik për zbatimin e dispozitës së mos dënimit të ligjvënies kombëtare edhe në praktikë (shikoni paragrafin 151). Zbulimet dhe rekomandimet ishin diskutuar në një ngjarje të zhvilluar në vitin 2015. Përveç kësaj, me mbështetjen e GIZ-it, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Nën-Grupin për Luftë kundër Trafikimit me Fëmijë kanë bërë analizë të identifikimit dhe mbrojtjes së fëmijëve viktimë të TQNJ.

49. Duhet të theksohet edhe raporti hulumtues i publikuar në vitin 2014 nga ana e projektit "Mario" "Mbrojtja e Fëmijëve në Lëvizje", i financuar nga Komisioni Evropian dhe fondacionit "Ouk", që i mëson pikat e përbashkëta mes migracionit të fëmijëve, fëmijëve në rrugë dhe forcës punëtore të fëmijëve me qëllim të identifikimit të çështjeve dhe mundësive për avancim të mbrojtjes së fëmijëve që migrojnë dhe janë në lëvizje, si tej kufijve ashtu edhe brenda vendit.²¹

50. OJQ "Otvorena Porta / La Strada" ka zbatuar hulumtime për më tepër çështje dhe ka publikuar raportet vijuese:

- "Dëmshpërblim i Viktimave të Krimeve të Dhunshme – Sa do të kushtojë formimi i një fondi shtetëror?" i publikuar më vitin 2016, jep një analizë të burimeve të mundshme të mjeteve për themelimin të Fondit Shtetëror për dëmshpërblim të viktimave të veprave të dhunshme kriminele.
- "Jeta pas Trafikimit me Qenie Njerëzore – Re-integrimi i Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore 2007-2014", në të cilën përmbledhen rezultatet më të rëndësishme nga programi i ri-integrimit (shikoni paragrafin 113);
- Raporti për Ligjvënien dhe Politikën e Pengimit të Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Zbatimi i Tyre në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" i publikuar në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Ballkani vepron tani (kundër veprës kriminele të trafikimit me qenie njerëzore)!" (BAN) në vitin 2016;²²
- Hulumtimi i perceptimit të qytetarëve dhe kuptimi i tyre mbi trafikimin me qenie njerëzore dhe eksploatimit për punë (shikoni edhe paragrafin 56), në drejtim të përcaktimit të masave të ardhshme për ngritjen e vetëdijes publike.

51. Në vitin 2015 IOM-i ka publikuar raportet rajonale të fëmijëve të pashoqëruar, ndërsa në vitin 2014 ka bërë vlerësim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe për "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", të dy të financuar nga Fondi Zhvillimor i IOM-it.

52. GRETA ka vërejtur që Plani Kombëtar i Veprimit 2017-2020 përmend iniciativë të ardhshme hulumtuese, përfshirë edhe për trafikimin me fëmijë dhe grupe tjera të cenuar, si dhe për qasjen për dëmshpërblim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. **GRETA përsëritet gjitha përpjekjet hulumtuese të autoriteteve kombëtare dhe konsideronit që duhet të**

²¹Vati, Zana, Fëmijë dhe Adoleshentë që Angazhohen për Punë në Rrugë në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë": Lëvizja, Cenueshmëria dhe Rezistenca, projekti "Mario", Budapest, dhjetor 2014, mund të gjendet në http://tdh-europe.org/upload/document/7228/Mario_Macedonia_Web.pdf

²²Mund të gjendet në: <http://www.lastrada.org.mk/mainarchive/monitoring%20report%20MAK-ENG.pdf>

vazhdohet me zbatimin dhe mbështetjen e hulumtimeve për çështje lidhur me TQNJ, dhe gjatë kësaj duke kushtuar vëmendje të madhe të TQNJ për shkak të eksploatimit me punë, trafikim me qenie njerëzore dhe trafikim të brendshëm të qenieve njerëzore.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

III. Konstatime sipas neneve

1. Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore

a.Masa për ngritjen e vetëdijes së TQNJ (Neni 5)

53. Ngritja e vetëdijes për TQNJ mbetet një moment kyç për veprimin parandalues i autoriteteve kombëtare. Gjatë periudhës raportuese ishin zbatuar aktivitete për ngritjen e vetëdijes për TQNJ në partneritet me OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe donatorë të huaj.²³ Komisioni Kombëtar çdo vit zbaton fushatën kombëtare "Java e Luftës kundër TQNJ", që matet për të përputhur me Ditën Evropiane për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, më 18 tetor.

54. OJQ "Otvorena Porta / La Strada" ka zbatuar fushatë kombëtare mediatike me titullin "Ngre Zërin kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore" në vitin 2014-2015 me qëllim të ngritjes së vetëdijes publike, veçanërisht në mesin e të rinjve, dhe të kontribuohet për përmirësim të identifikimit të viktimave. Si pjesë e kësaj fushate ishin transmetuar video dhe radio klipe, janë shpërndarë materiale informative, dhe ishin organizuar edhe prezantime mediatike dhe ngjarje të hapura. "Otvorena Porta / La Strada" gjithashtu ka organizuar edhe një ngjarje për gazetarë për njoftimin mbi TQNJ. Përveç kësaj "Otvorena Porta / La Strada" ka organizuar edhe punëtori në Gjevgjeli, Veles dhe Shkup për të sensibilizuar popullatën që jeton në këto pjesë. Më tutje, "Otvorena Porta / La Strada" ka promovuar aplikacionin celular "Ndaloni Trafikimin e Qenieve Njerëzore" si pjesë e projektit "Ballkani vepron tani (kundër veprës kriminele trafikimi me qenie njerëzore)!" Iniciativa qytetare "Semper" me seli në Manastir, ka përpunuar disa fletushka dhe materiale informative për TQNJ, me financa nga BE-ja.

55. Me përjashtim të fushatës mediatike "Ngrit Zërin kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore", nuk është vlerësuar efekti i këtyre masave për ngritjen e vetëdijes. Ndonëse janë marrë masat e përmendur më lartë, sipas mendimit të përfaqësuesve të shoqërisë qytetare dhe organizatave ndërkombëtare, nuk ka vetëdije mjaft të zhvilluar për TQNJ tek popullata e përgjithshme. **GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë me zbatimin e fushatave informative dhe fushatave për ngritjen e vetëdijes për TQNJ. Masat e ardhshme për ngritjen e vetëdijes duhet të planifikohen në mënyrë që do të merren parasysh vlerësimet e ndikimit të masave paraprake, duke u fokusuar mbi nevojat e identifikuar dhe grupet e synimit dhe duke përfshirë vëmendjen e ndryshimeve të reja ligjore dhe trendët e reja. Duhet posaçërisht të kushtohet vëmendje mbi ngritjen e vetëdijes për TQNJ për shkak të eksploatimit për punë, lëmosha me forcë, martesat me dhunë, bërja e veprave kriminele me dhunë dhe trafikim i brendshëm i qenieve njerëzore.**

b.Masa për parandalimin e TQNJ për shkak të eksploatimit për punë (Neni 5)

56. Autoritetet Kombëtare kanë treguar për disa masa për ngritjen e vetëdijes për të

²³Për më tepër detaje, shikoni përgjigjet e pyetjes 8 dhe 22 të Përgjigjeve të "Ish Republikës Jugosllav të Maqedonisë" për Pyetësin e GRETA për raundin e 2-të të vlerësimit dhe Raporti i dorëzuar nga autoritetet kombëtare për masat e ndërmarra për përputhje me Rekomandimin CP(2014)13 për zbatimin e Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Komitetit të Palëve Kontraktuese

parandaluar TQNJ për shkak të eksploatimit për punë. Për shembull, në kuadër të "Javës për Luftë kundër TQNJ" në vitin 2014, Komisioni Kombëtar, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe OJQ "Otvorena Porta / La Strada" kanë organizuar konferencë kombëtare me fokus të veçantë mbi eksploatimin për punë. Në vitin 2015, OJQ "Za Sreknio Detstvo" ka zhvilluar një fushatë mediatike për ngritjen e vetëdijes së opinionit për TQNJ për shkak të eksploatimit për punë. Më tutje, në vitin 2014 janë zbatuar edhe dy punëtori të synuar për studentët që kanë pasur për qëllim të punojnë jashtë shtetit. Vetëm më ishte theksuar për hulumtimin e perceptimit dhe kuptimit të qytetarëve për TQNJ dhe eksploatimit për punë, që ishte zbatuar nga OJQ "Otvorena Porta / La Strada" (shikoni paragrafin 50).

57. Siç vetëm më ishte vërejtur nga raporti i parë i vlerësimit të GRETA, inspektorët e punës kanë mandat të bëjnë inspektime të gjitha sektorëve ekonomik, të hyjnë në hapësirë afariste në çdo kohë dhe të analizojnë gjitha hapësirat dhe të kontrollojnë nëse personat në fjalë kanë kontrata për punësim.²⁴ Megjithatë, inspektorët e punës nuk kanë autorizim të kontrollojnë subjektet e paregjistruara afariste dhe shtëpitë private. Gjatë kohës së vizitës së dytë të vlerësimit të GRETA, 150 inspektorë të punës ishin punësuar në Inspektoratin Shtetëror të Punës. Sipas autoriteteve kombëtare, në vitin 2015 Inspektorati Shtetëror i Punës ka zbatuar 22.973 inspektime dhe ka vepruar sipas 2.512 denoncimeve nga të punësuar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Gjatë kohës së këtyre inspektimeve ishin zbuluar 237 persona pa kontratë për punësim, që me miratimin e 177 vendimeve me të cilat ju është kërkuar punëdhënësve të firmosin kontratë për punësim me punëtorët e papunësuar. Në 265 raste ishin shqiptuar edhe gjoba.

58. Në vitin 2016, si një pjesë e kornizës së programuar e BE-së dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqisë", Këshilli i Evropës ka filluar projektin "Parandalimi dhe Pengimi i TQNJ" në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", që zbatohet në partneritet me Koordinatorin Kombëtar, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Inspektorati Shtetëror, Ministrinë e Jashtme, Ministria e Drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë qytetare. Projekti ka për qëllim të mbështet Autoritetet Kombëtare për parandalimin dhe pengimin e TQNJ për shkak të eksploatimit në punë, por edhe të lehtësojë qasjen e viktimave deri në dëmshpërblim dhe kthim të sigurt dhe re integrim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Si pjesë e këtij projekti, ishte përpiluar raport për trafikim me qenie njerëzore për shkak të eksploatimit, me të cilën ishte analizuar gjendja kombëtare, ligjore dhe institucionale dhe standardet ndërkombëtare, dhe ishin dhënë rekomandime për veprime të mëtutjeshme. Raporti ishte prezantuar në seminarin e zhvilluar më 28 qershor 2017 në Shkup. Si pjesë e projektit janë organizuar trajnime për inspektorët e punës (shikoni paragrafin ...), dhe planifikohet edhe publikim i manualit për inspektorët e punës.


59. Në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit 2017-2020, Komisioni Kombëtar do të zgjerohet me anëtarë të Lidhjes së Sindikatave, Organizatës së Punëtorëve dhe Odës Ekonomike. GRETA dëshiron të njoftohet për rrjedhat në këtë fushë.

60. GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të zmadhojnë përpjekjet e tyre për parandalim të TQNJ për shkak të eksploatimit për punë, veçanërisht:

- **të vazhdojnë me ngritjen e vetëdijes së rreziqeve nga trafikimi me qenie**

²⁴V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 138.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



njerëzore për shkak të eksploatimit të punës si në vend ashtu edhe jashtë vendit;

- **të trajtojnë dhe sensibilizojnë personat zyrtarë meritore, veçanërisht inspektorët e punës, prokurorët dhe gjykatësit për TQNJ për shkak të eksploatimit të punës dhe për të drejtat e viktimave;**
- **të zgjerojnë mandatin e inspektorëve të punës në mënyrë që të përfshijnë edhe subjektet afariste të përgjithshme dhe shtëpitë private dhe të jepen resurse dhe drejtime që të mund në mënyrë aktive të angazhohen në parandalimin e TQNJ;**
- **të prezantojnë licencim dhe monitorim të agjencive për punësim të përhershëm ose përkohshëm;**
- **të angazhohen edhe sindikatat në sektorin privat, në përputhje me Parimet Prijëse për Afarizëm dhe të Drejta të Njeriut.²⁵**

c.Masa për parandalimin e trafikimit me fëmijë (Neni 5)

61. Në raportin e parë, GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet të kushtojnë më tepër vëmendje masave parandaluese që do të përputhen me prekshmërinë specifike të fëmijëve ndaj trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht fëmijëve nga grupet e cenuar sociale.

62. Autoritetet Kombëtare kanë vërejtur një numër të madh të masave parandaluese drejtuar ndaj trafikimit me fëmijë, që kanë qenë të zbatuar nga organet shtetërore, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëritë qytetare gjatë periudhës së raportimit.²⁶Për shembull, Ministria e Punëve të Brendshme ka zbatuar 336 punëtori për TQNJ dhe trafikim me fëmijë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme nga Manastiri, Tetova dhe Kumanova, me numër të lartë të vizitave prej 8.767 nxënësve.Në vitin 2014, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka zbatuar trajnim për mësimdhënësit, si dhe për psikologët dhe pedagogët e shkollave për temën "Parandalimi i Rreziqeve Sociale dhe TQNJ", në bashkëpunim me Qendrën Ndrëkomunale për Punë Sociale Probishtip.

63. OJQ "Otvorena Porta / La Strada" ka zhvilluar dy punëtori për TQNJ me 130 studentë të Institutit për Punë Sociale pranë Fakultetit Filozofik në Shkup dhe Universitetin Ndërkombëtar Sllavjan në Sveti Nikollë dhe Manastir.Më tutje, "Otvorena Porta / La Strada" ka zbatuar një garë multimediale për nxënës të shkollave të mesme për pengimin e TQNJ, dhe rezultatet ishin publikuar në Facebook.Përveç kësaj, kanë organizuar edhe shtatë punëtori në Shkup, Shtip dhe Delçevë në temën e martesave adoleshente, me pjesëmarrjen e 127 fëmijëve dhe 93 prindërve, kryesisht duke diskutuar me komunitetin rom.

64. Çdo vit, Iniciativa Qytetare "Semper" dhe Komisioni Lokal për Luftë kundër TQNJ dhe Migracionit të Paligjshëm në Manastir organizojnë ekspozitë arti për fëmijë në temën e TQNJ.Në vitin 2015 kanë përgatitur një publikim me titullin "Njihni Trafikimin me Qenie Njerëzore me anë të Fotografisë", në të cilën ishin lëvizur rreth 100 vepra artistike të krijuara nga fëmijët.Ishte zhvilluar edhe një ngjarje promovuese publike në të cilën publikimi ishte shpërndarë nëpër institucionet arsimore.Përveç kësaj, në vitin 2014 në "Semper" kanë përpiluar edhe një manual për edukim të bashkëmoshatarëve për trafikim me qenie njerëzore, fillimisht të synuar për nxënësit e shkollave fillore (i financuar nga BE-ja) dhe pastaj kanë organizuar punëtori arsimore për pengimin e TQNJ për mësimdhënësit dhe nxënësit, si dhe për të rinjtë dhe prindërit e komunitetit rom në komunat e

²⁵http://www.ohchr.org/Documents/Publications/GuidingPrinciplesBusinessHR_EN.pdf

²⁶Për më tepër detaje, shikoni përgjigjet e pyetjes 8 dhe 22 të Përgjigjeve për Pyetësorin e GRETA për raundin e 2-të të vlerësimit: <http://rm.coe.int/greta-2017-6-rq2-mkd/168078a4f2>dhe Raporti i dorëzuar nga autoritetet kombëtare për masat e ndërmarra për përputhje me Rekomandimin CP(2014)13 për zbatimin e Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Komitetit të Palëve Kontraktuese, mund të gjendet në:<http://rm.coe.int/16806c0639>

Manastirit, Mogilla, Demir Hisar dhe Novaci.////////

65. Në vitin 2014, Kryqi i Kuq i "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" ka zbatuar punëtori për TQNJ në 16 qytete, me pjesëmarrje të plotë të 22 mësimeve dhe 2.415 pjesëmarrësve. Ishte zhvilluar edhe një dramë për TQNJ me titullin "Luzna" para publikut të përbërë nga nxënës të shkollave të mesme dhe fillore. Me rastin e Ditës Evropiane për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në vitin 2017 ishin organizuar punëtori për edukim të bashkëmoshatarëve me anë të degëve të Kryqit të Kuq në Kisella Voda, Karposh, Koçanë, Demir Hisar, Gostivar, Kavadar, Kërçovë, Negotinë, Ohër, Radovish, Resnjë, Strugë, Veles, Berovë, Dibër, Delçevë, Makedonski Brod dhe Sveti Nikollë, me të cilat ishin përfshirë diku rreth 500 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.²⁷

66. Përveç kësaj, OJQ-të kanë organizuar edhe një trajnim për 26 përfaqësues të shoqatave qytetare romë dhe nga Qendrat Informative Romë si dhe për 699 nxënës dhe studentë. Gjatë kohës së këtyre trajnimeve ishin trajnuar edhe 21 profesionistë të shkollave fillore në komunat e Karposhit dhe Gjorgje Petrov. Përveç kësaj, janë zhvilluar 41 shfaqje të dramës "Unë udhëtoj vetëm".

67. Për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë pranohet që janë posaçërisht të ekspozuar në rrezik të trafikimit me qenie njerëzore dhe keqpërdorim. Numri i fëmijëve të huaj të pashoqëruar në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" është rritur prej 40 në vitin 2011 deri më 3.199 në periudhën prej 19 deri 30 shtator 2015, kur rrjedhat e migracionit kanë arritur kulmin. Duke e njohur nevojën për qasje multidisiplinore, ndër resorë dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë, Autoritetet Kombëtare kanë hartuar PSO për veprim me fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, që kanë qenë të hartuar me mbështetjen e UNHCR dhe janë prezantuar në nëntor 2016. Për shembull, GRETA ishte njoftuar për një rast të një gruaje të re nga Nigeria që kishte marrë mbrojtje subsidiare. Gjatë kohës së procedurës ishte konstatuar që ka pasur 21 vit, dhe që me siguri në një moment të udhëtimit të saj ka qenë e trafikuar. Në qershor 2016 ishte vendosur në Shtëpinë e Sigurt që udhëheq OJQ "Shërbimi Jezuit për Refugjatë". Gjatë kohës së vizitës së GRETA, ajo vetëm më ishte larguar nga Shtëpia dhe nga vendi.

68. Fëmijë në rrugë janë dukuri e vazhdueshme në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë". Në vitin 2015 UNICEF ka deklaruar që ka rreth 1.000 fëmijë në rrugë, prej të cilëve 95% janë romë.²⁸ Raporti i vitit 2015 i Entit Shtetëror të Statistikës për "Mbrojtjen Sociale të Fëmijëve, të Rinjve dhe të Moshuarve" tregon që ka 161 fëmijë të regjistruar në rrugë.²⁹ Përfaqësuesit e OJQ-ve me të cilët kanë zhvilluar takime gjatë vizitës së dytë të GRETA kanë shprehur shqetësim për mungesën e të dhënave të sakta të fëmijëve në rrugë në vend.

69. Fëmijët në rrugë të moshës 4 deri 14 kujdesen në Qendrat Ditore, që janë të hapura ose nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ose udhëhiqen nga OJQ që janë të ko-financuar nga

²⁷<http://ckrm.org.mk/en/october-18-european-anti-trafficking-day/>

²⁸UNICEF, Vlerësimi i gjendjes së fëmijëve në rrugë, Shkup, 2005; Raporti për Vlerësimin e Nevojave Specifike, Sfidat dhe Masat për Mbështetje Institucionale të Fëmijëve Romë në Rrugë, 2016, në përpunim të konzorciumit të udhëhequr nga Eptisa Evropë Juglindore SHPK, f. 14, mund të gjendet në: http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dekada/proekt_lokalna_integracija/1.Act%201%206_Assessment%20report%20with%20recommendations%20for%20care%20for%20Roma%20street%20children_Output%2012_EN.pdf

²⁹<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.16.12.pdf>

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Ministria.³⁰GRETA ishte njoftuar që përveç tre Qendrat Ditore aktuale, një qendër e ngjashme ishte hapur edhe nga ana e nj OJQ-je.Delegacioni i GRETA-s ka vizituar Qendrën Ditore për Fëmijë në Rrugë në lagjen e Shkupit, Kisella Vodë, që ishte vizituar edhe gjatë vizitës së parë për vlerësim.³¹Në ditën e vizitës ishin të pranishëm rreth 15 fëmijë.Personeli i qendrës ka theksuar problemet serioze me të cilat përballohen fëmijët në rrugën në kuptim të qasjes në mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale dhe regjistrim në shkollë, dhe ka theksuar nevojën urgjente të zvogëlimit të cenusshmërisë së tyre, veçanërisht të fëmijëve nga komuniteti rom, me atë që do të sigurohet regjistrimi i tyre gjatë lindjes.

70. Në raportin e parë, GRETA ka kërkuar nga Autoritetet Kombëtare që siglohet regjistrim i gjithë fëmijëve gjatë lindjes, si masë parandalimi për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore.GRETA ishte e njoftuar që edhe më tutje ka raste, veçanërisht të komunitetit rom, fëmijët mos të regjistrohen gjatë lindjes, andaj, për shkak të mungesës së certifikatave të lindjes dhe dokumenteve personale për prindërit e tyre dhe/ose për veten, ata nuk kanë qasje në mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale dhe arsim.Siç ishte vërejtur në raportin e parë të vlerësimit të GRETA-s, paraqiten komplikime plotësuese kur fëmijët dhe prindërit e tyre janë të lindur në Kosovë*.³²Grupi i Punës Mes Resorëve i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë për Administrimin e Librave Amë, OJQ rome dhe Qendrat Informative Rome, që ishte themeluar gjatë kohës së vlerësimit të parë të GRETA, edhe më tutje shtyn rrugën për dhënien e certifikatave të lindjes nga libri amë i të lindurve për gjithë fëmijët.Autoritetet Kombëtare kanë theksuar nevojën për ndryshimin e disa ligjeve, ndërsa Plani Kombëtar i Veprimit 2017-2020 parashikon marrjen e masave për përmirësim të sistemit të regjistrimit në librat amë me anë të masave administrative.Sipas të dhënave të UNHCR, në dhjetor 2014 ka pasur 734 persona pa shtetësi në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë".³³Këto të dhëna nuk janë ndarë sipas moshës, ashtu që nuk ka indikator që sa prej tyre janë fëmijë.Autoritetet kanë theksuar që në gusht 2017 ishin zgjedhur persona profesional për hartimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave për personat e paregjistruar dhe fëmijët në rrugë.Kjo metodologji do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë për Administrimin e Librave Amë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe do të fillojë të zbatohet pas thirrjes publike.

71. Plani Kombëtar i Veprimit 2017-2020 parashikon zbatimin e hulumtimit për fëmijët rom si dhe hartimi i bazave me të dhëna për fëmijë në rrugë.Autoritetet Kombëtare kanë theksuar edhe punën e Qendrave Ditore për Fëmijë në Rrugë të përmendur më lartë.Në vitin 2017 personeli i këtyre Qendrave ka marrë për detyrë të regjistrojë rastet e reja të këtyre fëmijëve me anë të punës në teren, si dhe të punojnë në motivimin e prindërve të fëmijëve të regjistruar të lejojnë të vizitojnë Qendrat Ditore.Autoritetet gjithashtu kanë theksuar që projektin që zbaton Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në bashkëpunim me Fondin Arsimor Rom, në 19 komuna, dhe që ka për qëllim përfshirjen e fëmijëve rom në çerdhe.Në kuadër të këtij projekte ishin organizuar më tepër punëtori për gra rome mbi rëndësinë e arsimit parashkollor, imunizimin dhe mbrojtjes parandaluese të fëmijëve të tyre.Një aplikacion i ri është dorëzuar tek Fondi Arsimor Rom për periudhën 2017-2019.

72. Gjatë kohës së vizitës vlerësuese vëmendjen e GRETA-s kanë tërhequr rastet e martesave të fëmijëve, adoleshentëve ose ato me dhunë në komunitetin rom.Sipas autoriteteve, Qendrat për Punë Sociale e monitorojnë situatën dhe miratojnë masa për parandalimin e martesave të fëmijëve, përfshirë edhe me anë të përforcimit të shkathtësive të prindërve, monitorimit të përdorimit të të drejtave të prindërve dhe marrja e masave për mbrojtje të të drejtave dhe interesave të fëmijës, nëse e nevojshme, edhe me anë të vendosjes së fëmijës në familje tjetër

³⁰Sipas "Raporti për Vlerësimin e Nevojave Specifike, Sfidat dhe Masat për Mbështetje Institucionale të Fëmijëve Rom në Rrugë" në vitin 2015 në Qendrat Ditore ishin kujdesur rreth 190 fëmijë të rrugës, ndërsa gjithsej 600 fëmijë në rrugë i kanë përdorur shërbimet e dy Qendrave Ditore në Shkup që prej hapjes së tyre, shikoni faqet 8 dhe 15.

³¹V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 121.

³²V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 118.

³³Rrjeti Evropian kundër Pa Shtetësisë, vendosja e fundit të pa shtetësisë për fëmijët, dokument pune 02/15, f. 4, mund të gjendet në: http://www.statelessness.eu/sites/www.statelessness.eu/files/Macedonia_0.pdf

ose institucion dhe nisja e procedurës për marrjen e të drejtës prindërore. Në rrjedhë është procesi konsultues me institucionet kompetente shtetërore dhe shoqata rreth ndryshimeve të mundshme të ligjeve me qëllim të tejkalohen problemet në këtë fushë.

73. Duke përkujtuar për rekomandimin e dhënë në raportin e parë, **GRETA sërish kërkon nga Autoritetet Kombëtare të marrin hapa me të cilët do të mundësohet regjistrim i gjithë fëmijëve gjatë lindjes.**

74. **Më tutje, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përforcojnë përpjekjet e tyre në fushën e parandalimit të trafikimit me fëmijë, duke përdorur rezultatet e hulumtimeve për trendët e reja, me anë të përforcimit të kapaciteteve dhe resurseve të profesionistëve që punojnë në mbrojtjen e fëmijëve, ngritjen e vetëdijes për trafikim me fëmijë dhe manifestimet e ndryshme (përfshirë edhe lëmshën e dhunuar, hyrje në martesë dhe kryerja e veprave kriminele) dhe sigurim të mjedisit mbrojtës për fëmijët në rrugë dhe fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë.**

ç. Iniciativa sociale, ekonomike dhe tjera për grupe të cenuar të TQNJ (Neni 5)

75. Në raportin e parë të vlerësimit, ndonëse ka përhëndetur masat që kanë ndërmarrë Autoritetet Kombëtare në lidhje me grupet e cenuar të TQNJ, GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë me zhvillimin e aspektit të parandalimit me anë të masave për fuqizim social dhe ekonomik.

76. Duhet të theksohet projekti "Maqedonia Punëson" që autoritetet kanë ngritur me qëllim të zvogëlojnë papunësinë me anë të promovimit të hapës së vendeve të reja të punës, dhe gjatë kësaj të merren parasysh nevojat e grupeve të ndryshme të personave të papunë, si edhe të punëdhënësit. Me projektin nuk përshihen viktimat e TQNJ si një grup i veçantë, por drejtohet për personat e papunë që mund të bëhen të cenuar ndaj TQNJ, siç janë të rinjtë dhe personat e papunë gjatë kohë, prindërit e vetëm, viktimat e dhunës familjare dhe personat me aftësi të kufizuar.

77. Në komentin e propozim-raportit të GRETA, autoritetet kanë theksuar punën që e bëjnë Qendrat Informative Rome, prej të cilëve tetë janë të vendosur në Qendrat për Punë Sociale, tre në komunat dhe një prej tyre vepron në kuadër të një OJQ-je. Këto Qendra sigurojnë informacione, këshillim dhe mbështetje logjistike në fushën e mbrojtjes sociale, punësimit, shëndetësisë, strehimit, arsimit dhe marrjes së dokumenteve personale. Më tutje, si pjesë e programit ROMED i Këshillit të Evropës, ndërmjetësuesit rom janë bërë aktiv në 10 komuna dhe ndihmojnë popullatën rome të keqe qasje në punësim, shërbime shëndetësore dhe arsim. Një program tjetër i Këshillit të Evropës, me titull ROMA KTED ("Promovimi i Drejtimit të Mirë dhe Fuqizimit të Romëve në Nivelin Lokal"), ka filluar me zbatim në dhjetor të vitit 2017.³⁴ Një projekt tjetër meritohet është edhe "Integrimi Lokal i Refugjatëve, Personave të Zhvendosur të Brendshëm dhe Grupe Minoritare", me të cilin janë zhvilluar punëtori në 12 komuna.

78. Siç ishte theksuar në paragrafin 14, numri i migrantëve që kanë kaluar nëpër "Ish

³⁴<http://pjp-eu.coe.int/en/web/roma-local-governance/>

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Republikën Jugosllave të Maqedonisë” në vitin 2015-2016 ishte relativisht i lartë. Në qershor 2016, Qeveria ka hartuar PSO për veprim me kategori të cenuar të shtetasve të huaj, në bashkëpunim me UNHCR. Qëllimi i tyre është të sigurohet mbrojtje dhe ndihmë për kategoritë e cenuar të huajve në rrjedhat e përziera të migracionit.

79. Delegacioni i GRETA-s ka vizituar Shtëpinë e Sigurt për kategori të cenuar të migrantëve dhe kërkues të azilit që udhëheq OJQ-ja ndërkombëtare "Shërbimi Jezuit për Refugjatë" (JRS) prej qershorit 2015, e bashkë-financuar nga Banka Qendrore Evropiane dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Në Shtëpinë e Sigurt mund të vendosen deri më 36 persona, përfshirë edhe viktimat të supozuar të trafikimit me qenie njerëzore të identifikuar mes migrantëve dhe azilkërkuesve (shikoni paragrafin 109). Azilkërkuesit mund të qëndrojnë në Shtëpinë e Sigurt deri sa të merret vendim për kërkesën e tyre për azil; megjithatë GRETA ishte informuar që vetëm një pjesë e vogël e tyre presin rezultate për dhënie të azilit.

80. GRETA thekson edhe shqyrtimet përfundimtare të raportit periodik të kombinuar të katër dhe të pestë për "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", të miratuar nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave të Kombeve të Bashkuara në seancën e 54 (11 shkurt-1 mars 2013), në të cilën Komiteti ka ftuar Autoritetet Kombëtare të marrin gjitha masat e nevojshme për të ngritur vetëdijen e mediave për nevojën e eliminimit të stereotipave gjinore, të ngritët vetëdija publike dhe të sigurohet trajnim i detyrueshëm për gjykatës, avokatë, nëpunës policor, punëtorët shëndetësor dhe social si dhe kuadrin mësimor për të siguruar që gjithë këto të sensibilizohen për gjitha format e dhunës mbi gratë dhe vajzat dhe të mund të ofrojnë mbështetje përkatëse të ndjeshme gjinore viktimave, si dhe të inkorporohet një qasje e ndjeshme gjinore për veprim me azilkërkuesit dhe refugjatët, përfshirë edhe në fazën e paraqitjes së kërkesës për azil.³⁵ Siç vetëm më ishte theksuar në paragrafin 38, në vitin 2016 ishte zhvilluar një trajnim për nëpunësit policor, punëtorët social dhe OJQ-të në të cilat ishte shqyrtuar dimensionin gjinor i TQNJ.

81. Ndonëse i njeh masat që merren për të përfshirë cenueshmërinë e refugjatëve dhe migrantëve për TQNJ, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përforcojnë përpjekjet në këtë fushë dhe të vazhdojnë me ndërmarrjen e hapave për ulje të cenueshmërisë së personave që takojnë komunitetin rom, veçanërisht grave dhe fëmijëve, drejt trafikimit me qenie njerëzore, me anë të masave sociale, ekonomike dhe tjera. Duhet të bëhen edhe përpjekje plotësuese për promovimin e barazisë gjinore, pengimin e dhunës së bazuar në gjini dhe stereotipat, dhe mbështetje për politika konkrete të fuqizimit të grave si mjet për pengimin e shkaktarit kryesor të TQNJ.

d. Masa për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore për marrje të organeve (Neni 5)

82. GRETA vëren që, ndonëse TQNJ për marrjen e organeve në kuptim të asaj të përcaktuar në Konventën, dhe trafikimi me organe në kuptim të asaj të përcaktuar në Nenet 4 deri 8 të Konventës kundër trafikimit me organe njerëzore të Këshillit të Evropës janë dy vepra penale të ndryshme, por sërish ndajnë një shkaktar të përbashkët, siç është mungesa e organeve për të plotësuar nevojat nga transplantimi dhe kushtet tjera ekonomike dhe tjera që vendosin njerëzit në gjendje të cenuar. Nga kjo, masat për parandalimin e trafikimit me organe mund të ndihmojnë të ndalohet trafikimi me qenie njerëzore për marrje të organeve, dhe anasjelltas.³⁶ Në mesin e masave të nevojshme parandaluese, GRETA e nënvizon rëndësinë e një sistemi të fuqishëm dhe transparent të marrjes dhe transplantimit të organeve njerëzore dhe nevoja për trajnim të

³⁵http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/MKD/CO/4-5&Lang=En

³⁶V. Studim i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Kombet e Bashkuara, Trafikimi me organe, Inde dhe Qeliza dhe Trafikimi me Qenie Njerëzore për Marrjen e Organeve, 2009, në veçanti faqet 55-56; OSBE, Trafikimi me Qenie Njerëzore për Marrje të Organeve në rajonet e OSBE-së: Analiza dhe zbulime, dokument përdorimi nr. 6 (2013).

punëtorëve shëndetësor.GRETA gjithashtu thekson rëndësinë e zbatimit të një hulumtimi të hollësishëm për secilin rast ku ka informacione ose dyshim për trafikim me qenie njerëzore për marrje të organeve, duke kushtuar vëmendje që mos të keqpërdoret cenueshmëria e "dhuruesit" dhe të sigurohet që me "dhuruesin" të veprohet sikur me viktimë të trafikimit me qenie njerëzore.**GRETA i inkurajon Autoritetet Kombëtare të firmosin dhe ratifikojnë Konventën kundër trafikimit me organe njerëzore të Këshillit të Evropës.**

83. Në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", TQNJ për shkak të marrjes së organeve është kriminalizuar në përputhje me Nenin 418-a (trafikimi me qenie njerëzore) dhe 418-ç (trafikim me fëmijë) të KP.Me Nenin 10 të Ligjit për Marrje dhe Transplantim të Pjesëve të Trupit të Njeriut ndalohet trafikimi me organe njerëzore, si dhe reklamimi i ofertave për shitje ose blerje të pjesëve të trupit.Shoqata Maqedonase për Transplantim të Organeve dhe Inde e mbështet Deklaratën e Stambollit për ndalesë të trafikimit me qenie njerëzore dhe turizmit për shkak të transplantimit të miratuar më vitin 2008 dhe obligohet të ndërtojë parime e kësaj Deklarate në aktivitetet lidhur me transplantimin.

84. Sipas autoriteteve kombëtare, procedurat për dhurim dhe marrje të organeve, indeve dhe qelizave janë të rregulluar me dispozita qeveritare.³⁷Ministria e Shëndetësisë, Koordinatori Kombëtar për transplantim të pjesëve të trupit të njeriut dhe Koordinatori Kombëtar për qeliza amë hematopeze janë kompetent për monitorimin e procedurave për transplantim dhe kujdes shëndetësor dhe shërbim të dhuruesve dhe marrësve.Ministria e Shëndetësisë e udhëheq, monitoron dhe drejton listën e pritjes së transplantimit të pjesëve të trupit të njeriut.

85. GRETA ishte njoftuar që nuk ka pasur raste të TQNJ për marrje të organeve.

86. GRETA konsideron që punëtorët shëndetësor të përfshirë në transplantimin e organeve dhe profesionistët tjerë meritohet të sensibilizohen për TQNJ për shkak të marrjes së organeve me anë të trajnimeve dhe dhënieve të udhëzimeve.

dh.Masa për frenimin e kërkesës (Neni 6)

87. Në raportin e parë të vlerësimit, GRETA ka ftuar autoritet kombëtare të vazhdojnë me përpjekjet për frenimin e kërkesës nga shërbimet që japin personat e trafikuar, për gjitha format e eksploatimit, në partneritet me sektorin privat dhe shoqërinë qytetare.

88. Autoritetet Kombëtare theksuan një numër të lartë të aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes (siç është mirëmbajtja e punëtorëve, fushata mediatike, gara, ligjërata dhe konferenca) që janë zbatuar me qëllim të informimit të publikut për gjitha aspektet e dukurisë së trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë edhe qëllimi për të frenuar kërkesa nga shërbime të personave të trafikuar.³⁸

89. Duhet të theksohet raporti hulumtuese i publikuar nga OJQ "Otvorena Porta / La Strada"

³⁷Gazeta Zyrtare Nr.47/2011, 136/2011, 91/2013 dhe nr.168 të 3 dhjetorit 2013. Për më tepër detaje, shikoni përgjigjet e pyetjes 21 a dhe 6 të Përgjigjeve për Pyetësorin e GRETA për raundin e 2-të të vlerësimit.

³⁸Për më tepër detaje, shikoni përgjigjet e pyetjes 8 dhe 22 të Përgjigjeve për Pyetësorin e GRETA për raundin e 2-të të vlerësimit dhe Raporti i dorëzuar nga autoritetet kombëtare për masat e ndërmarra për përputhje me Rekomandimin CP(2014)13 për zbatimin e Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Komitetit të Palëve Kontraktuese.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

për kushtet e punës në industrinë e prodhimit të këpucëve në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" si dhe në pesë vende tjera evropiane me fuqi të lirë punëtore.³⁹Raporti ngrit vetëdijen për lidhjen e ndërsjellë të tregtimit global me veshmbathje dhe vende me fuqi të lirë punëtore dhe thekson nevojën për përgjegjësi sociale dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut të punëtorëve në zinxhirin e furnizimit.

90. Më tutje, Autoritetet Kombëtare kanë theksuar edhe projektin "Parandalimi i TQNJ në zinxhirin e furnizimit me anë të praktikave dhe masave qeveritare" i përpiluar nga ana e Zyrës së Përfaqësuesit Special dhe Koordinatorit për Luftë kundër TQNJ të OSBE-së, që shteteve pjesëmarrëse në OSBE do të sigurojë vegla dhe model-drejtime.

91. Plani Kombëtar i Veprimit 2017-2020 parashikon organizim të fushatave publike për kriminalizim të përdorimit të shërbimeve të viktimave të TQNJ si dhe masa për ngritjen e vetëdijes të synuar për sektorin privat dhe odat ekonomike për të zvogëluar TQNJ për shkak të eksploatimit për punë.

92. **GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për frenim të kërkesës së shërbimeve të personave të trafikuar, me anë të miratimit të masave ligjore, administrative, arsimore, sociale dhe kulturore për frenimin e kërkesës që nxit çfarëdo forme të eksploatimit që shpie drejt trafikimit me qenie njerëzore, në partneritet me shoqërinë qytetare, sindikatat dhe sektorin privat.**

e.Masa kufitare (Neni 7)

93. Në raportin e parë të vlerësimit GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet të investojnë përpjekje plotësuese për zbulimin e rasteve të TQNJ në kontekst të kontrollit kufitar dhe të prezantojnë një listë kontrolluese për identifikim të rreziqeve potenciale lidhur me TQNJ për përdorim të sistemit për kërkim të vizës.

94. Në vitin 2016 Komisioni Kombëtar, në bashkëpunim me IOM dhe me mbështetjen e Fondit për Migrantë dhe Refugjatë dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës, kanë hartuar Indikatorë për Identifikim të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në rrjedhat e përziera të migracionit.Dokumenti duhet të shërbejë si vegël për identifikimin e profesionistëve që kanë kontakt me viktimat e mundshme të TQNJ.Kontrolli fillestar i kalimit kufitar bëhet nga person zyrtar ose përfaqësues i shoqërisë civile ose organizatës ndërkombëtare.

95. Për të identifikuar më mirë personat e cenuar të TQNJ mes kërkuesve të vizës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme kanë përpiluar një pyetësor që duhet të përdoret nga stafi në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore si dhe në kalimet kufitare kur bëjnë intervista kërkuesve të vizës.

96. Autoritetet Kombëtare kanë njohur nevojën për ngritjen e vetëdijes së personalit të punësuar tek transportuesit komercial për të zbuluar dhe denoncuar rastet e TQNJ.**GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përfshijnë këtë personel në Planin Ndër Resor për Trajnim.**

97. Ndonëse përshëndet përpilimin e Indikatorëve për Identifikim të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Rrjedha të Përziera të Migracionit, **GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë me përpjekjet për zbulimin de viktimave potenciale në kalimet kufitare dhe të sigurojnë shërbimeve meritore trajnime me të cilat do të aftësohen për zbulimin e hershëm dhe referim të viktimave të mundshme të TQNJ të grupeve të cenuar, siç janë migrantë dhe azilkërkues, përfshirë edhe fëmijë të pashoqëruar dhe të ndarë.**

³⁹Mund të gjendet në: <http://www.lastrada.org.mk/mainarchive/labour-on-a-shoestring.pdf>

2. Masa për mbrojtje dhe avancim të të drejtave të viktimave, me garanci për barazi gjinore

a. Identifikimi i viktimave të TQNJ (Neni 10)

98. Në raportin e vlerësimit GRETA kërkoi nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin masa plotësuese për të siguruar viktimat e trafikimit me qenie njerëzore të identifikohen në mënyrë të drejtë dhe të mund të përfitojnë nga masat e ndihmës dhe mbrojtjes që janë të garantuar me Konventën. GRETA ka theksuar nevojën e zbatimit të një qasjeje më pro aktive për identifikim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore për shkak të eksploatimit për punë dhe kushtimin e më tepër vëmendjes identifikimin e viktimave në mesin e migrantë të parregullt dhe kërkuesve të azilit.

99. PSO për veprim me viktimat e TQNJ⁴⁰, të miratuar në vitin 2008 dhe të reviduar në vitet 2010 dhe 2012 i përcaktojnë rolet dhe detyrat e aktorëve të ndryshme gjatë kohës së procesit të identifikimit. Identifikimi fillon nga momenti i marrjes së informacioneve, për ose gjatë realizimit të kontaktit të parë me viktimën e mundshme. Kjo mund të zhvillohet në mënyra të rëndësishme: me anë të aktiviteteve të policisë, Qendra për Punë Sociale, inspektorët e punës, prokurorët, institucionet shëndetësore, shkollat, ambasadat, OJQ ose kur viktimat e supozuar vetë do të kontaktojnë autoritetet ose OJQ-të. Identifikimi bëhet me anë të intervistës që e zhvillojnë përfaqësues të Njësisë Policore për Pengimin e TQNJ dhe kontrabandës së migrantëve dhe/ose nga Zyra e MKR, për të cilën punojnë një rrjet i punëtorëve të trajnuar social në gjithë vendin.⁴¹ Përfaqësuesit e OJQ-ve me të cilët kanë realizuar takime gjatë vizitës së dytë të vlerësimit kanë shprehur shqetësimin që PSO nuk janë reviduar që nga viti 2012. ⁴²**GRETA i fton Autoritetet Kombëtare që të sigurohet se POS për veprim me viktimat e TQNJ të revidohen rregullisht që të jenë në hap me trendët e reja të TQNJ.**

100. Në raportin e parë të vlerësimit GRETA ka vërejtur që puna e gjashtë ekipeve mobile është mjaft premtuese të cilët në mënyrë pro aktive zbulojnë viktimat e TQNJ dhe ofrojnë shërbime për re-integrim.⁴³ Pas përfundimit të pilot projektit me të cilin ishin themeluar këto ekipe mobile, dhe duke marrë parasysh punën e tyre efektive, Komisioni Kombëtar, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale ka nisur procedurë për themelimin e ekipeve mobile që do të mbesin të qëndrueshëm dhe të integruar në sistemin. Në shtator të vitit 2017 ishte zhvilluar një takim pune me përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, anëtarët e Sekretariatit të Komisionit Kombëtar, OJQ dhe anëtarët e ekipeve mobile, në të cilën ishte diskutuar për funksionet dhe përgjegjësitë e ekipit.

101. Në lidhje me masat për identifikim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në mesin e

⁴⁰Mund të gjendet në: http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/operativni_eng.pdf

dhe <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/operativni.pdf>

⁴¹V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 133 dhe 134.

⁴²Otvorena Porta / La Strada, Monitorimi dhe vlerësimi i ligjeve dhe politikave për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe zbatimimi i tyre në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", 2016, f. 53.

⁴³V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 137.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

refugjatëve dhe migrantëve që hyjnë në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", vetëm më ishte theksuar miratimi i Indikatorëve për Identifikim të Viktimave të TQNJ në Rrjedhat e Përziera të Migracionit, që kanë qenë të hartuar në vitin 2016 (shikoni paragrafin 93).

102. GRETA në mënyrë të shqetësuar vëren që ndonëse janë bërë PSO dhe përpjekje të madhe për trajnim dhe ngritje të vetëdijes, numri i viktimave formale të identifikuar të TQNJ ka rënë gjatë viteve të fundit. Shumë raportet të përfaqësuesve të organeve shtetërore, OJQ dhe organizata ndërkombëtare e ndajnë mendimin që, duke marrë parasysh gjendjen e ndryshuar me migracionin, Qeveria ka zvogëluar resurset financiare dhe njerëzore të synuar për identifikim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht të Zyrës së MKR dhe të Njësisë Policore për Pengimin e TQNJ dhe Kontrabandë të Migrantëve.

103. Siç ishte vërejtur në paragrafët 12 dhe 13, mendohet që numri i viktimave potenciale të TQNJ është shumë më i lartë nga numri i viktimave formale të identifikuar. Autoritetet kanë sqaruar që viktimë potenciale e trafikimit me qenie njerëzore është personi që në bazë të pozitës së cenuar dhe rrethanave, ka indikatorë që tregojnë se personi është ose mund të bëhet viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, por identifikimi i nuk është i tërësishëm ose nuk është bërë eksploatim mbi atë person. Gjatë kohës së migracionit të përzier që ndodhi në vitin 2015-2016 ishin identifikuar me qindra viktima potencial të trafikimit me qenie njerëzore dhe atyre ju ishte ofruar mbrojtje dhe ndihmë, por ata kanë refuzuar, sepse qëllimi i vetëm i tyre ka qenë të largohen nga vendi sa më shpejtë që mundet dhe të vazhdojnë drejt destinacionit të fundit, që shpeshherë ka qenë Gjermania. Autoritetet kanë theksuar që në mënyrë të barabartë është vepruar si me ato të identifikuar ashtu edhe ato potenciale, por që ndihma dhe mbrojtja nuk kanë mundur të jepet pa pëlqimin e personit. Fëmijëve të pashoqëruar ju ishte caktuar një punëtor social si kujdestar, dhe ato janë kujdesur në një objekt të veçantë. Përveç rrjedhave të përziera të migracionit që janë zhvilluar në vitin 2015-2016, nuk ka pasur raste tjera të viktimave të potencial të identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore gjatë periudhës së raportimit.

104. Ndonëse është i ultë numri i rasteve të identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore për shkak të eksploatimit të punës, OJQ-të kanë shprehur shqetësimin e tyre rreth indikatorëve të rasteve të mundshme të trafikimit me qenie njerëzore për eksploatim të ndryshëm (posaçërisht në bujqësi, tekstil, estradë dhe ushqimore). Personat zyrtar, por edhe përfaqësuesit e shoqërisë qytetare dhe organizatat ndërkombëtare me të cilat ishte zhvilluar takime gjatë vizitës së dytë të vlerësimit të GRETA, kanë konstatuar nevojën e përforsimit të kapaciteteve të stafit të Inspektoratit Shtetëror të Punës që të mund të mënyrë më pro aktive të zbulojë TQNJ për shkak të eksploatimit për punë. GRETA vëren që PSO për veprim me viktima të TQNJ nuk i përfshijnë inspektorët e punës.

105. Ndonëse i njeh përpjekjet për miratimin e instrumenteve të reja për identifikim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, **GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapat plotësuese për të siguruar që gjitha viktimat të trafikimit me qenie njerëzore të identifikohen në mënyrë përkatëse dhe të mund të përfitojnë nga masat për ndihmë dhe mbrojtje të garantuar me Konventën, veçanërisht:**

- të promovohen qasje ndër resorëve në identifikimin e viktimave, me anë të formalizimit të rolit dhe kontributit të OJQ-ve të specializuara;
- të sigurohen resurset e nevojshme njerëzore dhe financiare me të cilat do të mundësohet nëpunësve policor, punëtorëve social, OJQ-ve dhe aktorëve tjerë meritator të zbatojnë një qasje më pro aktive dhe të rrisin shtrirjen e tyre në identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;
- të zmadhohen përpjekjet për identifikim pro aktiv të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore për shkak të eksploatimit për punë me an të përforsimit të rolit dh trajnimit të inspektorëve të punës, dhe sigurimi i veglave dhe resurseve për Inspektoratin Shtetëror të Punës që janë të nevojshme për ndalimin efektiv dhe pengimin e TQNJ;
- të kushtohet më tepër vëmendje për zbulimin e viktimave potenciale të

trafikimit me qenie njerëzore mes migrantëve dhe azilkërkuesve dhe të sigurohet qasje për interpretim për të lehtësuar gjithë procesin.

b.Masat për ndihmë (Neni 12)

106. Në raportin e saj të vlerësimit GRETA ka përshëndetur hapjen e Zyrës së MKR dhe Qendrës Shtetërore (Strehimores) për Viktima të TQNJ.Megjithatë, GRETA ka kërkuar nga Autoritetet Kombëtare të përforcojnë përpjekjet për dhënien e ndihmës viktimave të trafikimit me qenie njerëzore veçanërisht me anë të sigurimit të mjeteve përkatëse dhe lehtësimit të re-integrimit të viktimave të TQNJ.Më tutje, GRETA ka kërkuar nga Autoritetet Kombëtare të sigurojnë strehim përkatëse për fëmijët dhe viktimat burra të trafikimit me qenie njerëzore dhe të sigurohet që viktimat e supozuar të shteteve të huaja të vendosen në Strehimoren Shtetërore menjëherë pasi që të zbulohet arsyeja themelore dhe të besohet që janë viktima të trafikimit me qenie njerëzore.

107. Ndihma dhe mbrojtja e viktimave të TQNJ sigurohet nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Zyra e MKR, në bashkëpunim me Qendrat për Punë Sociale⁴⁴ dhe OJQ-të.Ligji për Mbrojtje Sociale e garanton të drejtën e viktimave të TQNJ të marri ndihmë dhe mbrojtje nga Qendra e Viktimave të TQNJ.⁴⁵

108. Sipas OJQ-ve me të cilat janë zhvilluar takime gjatë vizitës, gjatë periudhës së raportimit në mënyrë të dukshme është zvogëluar financimi i masave për ndihmë të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, për shkak të ngarkesës së madhe të resurseve shtetërore nga vala e refugjatëve dhe migrantëve në vend.Më para, që vetëm më ishte financim i kufizuar shtetëror i Strehimores Shtetërore, kishte rënë në zero në vitet 2015 dhe 2016.Përveç kësaj, në vitet 2015 dhe 2016 nuk ishin dhënë aspak grantet shtetërore në shumë prej 5.000 euro të së paku 5 OJQ-ve të specializuar për punë në fushën e TQNJ.Si Koordinatori Kombëtar ashtu edhe Njoftuesit Kombëtare kanë pranuar nevojën urgjente të financimit të qëndrueshëm shtetëror të punës së OJQ-ve për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore, dhe veçanërisht në kuptim të Strehimores Shtetërore të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore.Koordinatori Kombëtar theksoi që në shkurt 2017 deri tek Qeveria ishte dorëzuar kërkesë për dhënien e granteve shtetërore, gjatë së cilës ishte theksuar rëndësia e dhënies së granteve organizatave që ofrojnë ndihmë, mbështetje, re-integrim dhe ngritjen e vetëdijes publike në fushën e trafikimit me qenie njerëzore.

109. Delegacioni i GRETA ka vizituar Strehimoren Shtetërore të Viktimave të TQNJ (që ishte vizituar edhe paraprakisht gjatë vizitës së parë të GRETA).⁴⁶Sipas të dhënave që ka siguruar "Otvorene Porta / La Strada", 15 viktima ishin vendosur në Strehimoren në periudhën 2013-2016.⁴⁷Të gjitha viktimat ishin gra, shtetase të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" dhe

⁴⁴Gjithsej, ka 30 Qendra për Punë Sociale në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë"; Raporti Kombëtar i IOM, Mbështetja e Vendeve të Ballkanit Perëndimor për Përballimin Efektiv me Sfidat e Imponuar nga Migracioni i Adoleshentëve të Pashoqëruar, 2015, f. 29.

⁴⁵V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 147 dhe 148.

⁴⁶V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 148-151.

⁴⁷Sipas të dhënave që ka siguruar Otvorene Porta / La Strada, 8 viktima ishin vendosur në Strehimoren në periudhën 2013: 6 shtetase nga vendi dhe 2 shtetase serbe. Në vitin 2014, 5 viktima gra kanë qëndruar në Strehimoren: 4 shtetase të vendit dhe 1 shtetase rumune 20 vjeçare. Në vitet 2015 dhe 2016, 2 vajza 16 vjeçare ishin vendosur në Strehimoren.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

shumica më të reja se 18 vjeç.Gjatë kohës së vizitës së dytë të GRETA në Strehimore, nuk ishte vendosur asnjë viktimë.Për shkak të shkurtësive të buxhetit, OJQ "Otvorena Porta / La Strada" dhe "Za Srekno Detsvo", që kanë dhënë ndihmë viktimave në Strehimoren në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të firmosur me Qeverinë, kanë dashur vetë të gjinden për financa dhe të mbulojnë kujdesin e viktimave.Gjatë kohës së vizitës së GRETA nuk ishte e njohur nëse në vitin 2017 do të sigurohen mjete shtetërore për Strehimoren.Në vitin 2017, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka siguruar 295.836 denarë (rreth 4.800 euro) nga buxheti për funksionim të Strehimores Shtetërore të Viktimave të TQNJ.

110. Më tutje, siç ishte theksuar në paragrafin 78, GRETA ka vizituar edhe Shtëpinë e Sigurt për Kategori të Cenuar të Migrantëve dhe Azilkërkuesve, që udhëhiqet nga OJQ ndërkombëtare "Shërbimi Jezuit për Refugjatë" (JRS).Gjatë kohës së vizitës së GRETA 14 persona kanë qëndruar në Shtëpinë e Sigurt, përfshirë edhe tre familje dhe dy djem të pashoqëruar (nga Afganistani dhe Pakistani).GRETA ishte njoftuar që nga hapja e Shtëpisë së Sigurt pesë viktima të supozuar të TQNJ ishin të vendosur brenda.Shtëpia e Sigurt ofron shumë kushte të mira materiale, gjatë së cilës, familjet, burrat dhe gratë e vetëm, dhe fëmijët vendosen në dhoma fjetjeje të posaçme.Në Shtëpinë e Sigurt punojnë punëtorë social, kujdestarë të fëmijëve të pashoqëruar, psikologë, mësimdhënës dhe përkthyes të arabishtes dhe farsi.Delegacioni ishte njoftuar që stafi ka kaluar trajnim për TQNJ.

111. Delegacioni i GRETA gjithashtu ka vizituar edhe Qendrën e Pranimit për të Huaj në Shkup, në të cilën mbahen kategoritë e ndryshme të personave që nuk kanë rregulluar qëndrimin në vend, përfshirë edhe viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, deri sa nuk të marrin leje për qëndrim.⁴⁸Qendra, që ishte vizituar nga ana e GRETA-s edhe gjatë vizitës së parë⁴⁹, ishte relativisht në gjendje të keqe materiale, ndonëse një pjesë ishte rinovuar në vitin 2016.GRETA ishte njoftuar që kjo Qendër do të mbyllet dhe vetëm më ishte zgjedhur një vend për ndërtimin e një Qendre të re.Gjatë kohës së vizitës së GRETA pesë migrantë ishin mbajtur në Qendrën për të konstatuar identiteti i tyre.

112. OJQ-të kanë theksuar që personat që do të njihen si viktima të trafikimit me qenie njerëzore nuk marrin asnjë njoftim formal për atë, që ndonjëherë e vështirëson të marrin të drejtën e tyre për ndihmë juridike falas ose ndihmë shëndetësore falas.

113. Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore nuk janë përfshirë në mesin e kategorive që kanë të drejtë për mbrojtje shëndetësore, nëse nuk mund të marrin sigurim shëndetësor në ndonjë mënyrë tjetër.⁵⁰

114. Pas vlerësimit të parë të GRETA ishte miratuar Programi për Ndihmë dhe Mbështetje të Re-Integrimit të Viktimave të TQNJ.Për viktimat e TQNJ përpunohen Plane Individuale për Re-Integrim, ndërsa Qendrat për Punë Sociale janë përgjegjëse të ndjekin zbatimin përkatëse, në partneritet me institucione tjera në nivel lokal, siç është Agjencia e Punësimit, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe OJQ-të.Autoritetet Kombëtare në veçanti kanë theksuar mbështetjen për re-integrim që ofron OJQ "Otvorena Porta / La Strada" (siç është këshillim psiko-social, kujdes shëndetësor, programe arsimore dhe pako standarde të veshmbathjes, ushqimit dhe produkte të higjienës).⁵¹Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka organizuar trajnime për zbatim të programit për re-integrim në komunat e Koçanit, Probishitip, Kumanovë dhe Dibër për 60 përfaqësues të Qendrave për Punë Sociale, policinë, institucionet shëndetësore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe institucionet shtetërore.Dy projekte për re-integrim të viktimave, në të cilët kanë qenë të përfshirë

⁴⁸Sipas numrave të siguruar nga personat zyrtar të Qendrës për të Huaj, gjatë vizitës së GRETA-s, 19 të huaj kanë qenë të vendosur në janar dhe shkurt 2017, përfshirë edhe 2 gra. Në vitin 2016, numri i huajve të vendosur në Qendrën ka qenë 389, prej të cilëve 49 gra.Në vitin 2015, numri i huajve të vendosur në Qendrën ka qenë 1.346, prej të cilëve 249 gra.Pjesa më e madhe e të huajve të vendosur kanë qenë nga Siria, Afganistani dhe Iraku.

⁴⁹V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 155.

⁵⁰V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 153.

⁵¹Për më tepër detaje, shikoni Raporti i dorëzuar nga autoritetet kombëtare për masat e ndërmarra për përputhje me Rekomandimin CP(2014)13 për zbatimin e Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Komitetit të Palëve Kontraktuese.

edhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe OJQ "Otvorena Porta / La Strada" dhe "Ednakov Pristap", financiarisht ishin të mbështetur nga Fondacioni "Mbreti Boduen" nga Belgjika dhe GIZ.⁵²Sipas informacioneve të GRETA, këto projekte vetëm më kanë përfunduar.

115. GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapa për përmirësimin e ndihmës për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht:

- të sigurohen resurse përkatëse financiare dhe njerëzore për ndihmë të viktimave të supozuar dhe formalisht të identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë edhe me anë të dhënies së mandatit të OJQ-ve të specializuar të ofrojnë ndihmë;
- të sigurohen mjete përkatëse për ndihmë, përfshirë edhe akomodim, për viktimat e supozuar dhe formalisht të identifikuar të TQNJ;
- të përforcojnë mbështetjen për re-integrim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në shoqëri, me anë të ofrimit të trajnimit profesional, ndihmë për gjetjen e punës dhe dhënies së resurseve përkatëse për shërbimet që ndihmojnë viktimave për re-integrimin e tyre.
- të sigurohet strehim përkatës për viktimat e huaja të vendosen në Strehimoren Shtetërore menjëherë pasi që të zbulohet arsyeja themelore dhe të besohet që janë viktimat e trafikimit me qenie njerëzore.

c. Identifikimi dhe ndihma për fëmijët viktimat të TQNJ (Nenet 10 dhe 12)

116. Kur të zbulohet një fëmijë si viktimë e supozuar e trafikimit me qenie njerëzore, duhet të kontaktohet Qendra për Punë Sociale me qëllim që fëmijës të sigurohet mbrojtje e të drejtave dhe sigurisë, si dhe të jepet kujdestarë.⁵³Ligji për të Huaj dhe Ligji për Azil dhe Mbrojtje të Përkohshme janë ligjet thelbësore me të cilat rregullohet pozita e fëmijëve të pashoqëruar. Në pajtim me Nenin 112 të Ligjit për të Huaj, Ministria e Punëve të Brendshme, pasi që të identifikon një fëmijë të pashoqëruar, menjëherë njofton misionin diplomatik ose konsullor të vendit që fëmija ka origjinën për të identifikuar anëtarët e familjes më të afërt, dhe të njoftohen edhe organet kompetente që të mund të përcaktohet kujdestarë. Qendrat për Punë Sociale e emërojnë kujdestarin përkatës, që e përfaqëson fëmijën e pashoqëruar dhe punon për interesat më të mirë. Nëse fëmija i pashoqëruar nuk mund menjëherë të jepet organeve kompetente të vendit të origjinës, fëmija vendoset në Departament të Posaçëm për Fëmijë pranë Qendrës së Pranimit për të Huaj (shikoni paragrafin 110). Gjatë kohës së qëndrimit në Qendrën e Pranimit për të Huaj fëmija i pashoqëruar ka të drejtë për ndihmë ligjore, sociale, shëndetësore dhe psikologjike si dhe të arsimit. Me nenet 80, 81 dhe 82 nga Ligji për të Huaj rregullohet leje qëndrimi i përkohshëm dhe jepet fëmijëve të pashoqëruar për arsye humanitare. Në përputhje me Nenin 23, paragrafin 1 të Ligjit për Azil dhe Mbrojtje të Përkohshme nuk ka kornizë të caktuar kohore për emërimin e kujdestarit, por, për

⁵²V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 36 dhe 137.

⁵³V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 139.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

përcaktimin e kohës përdoret shprehja "sa më shpejtë që mundet". Në përputhje me Nenin 23, Paragrafi 4 i Ligjit për Azil dhe Mbrojtje të Përkohshme të Ministria e Punëve të Brendshme ka për detyrë të ndërmerr gjitha masat e nevojshme për të hyrë në gjurmë anëtarëve të familjes së fëmijës së pashoqëruar.

117. Në komentet e saja për raportin e GRETA, Autoritetet Kombëtare kanë theksuar që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, me anë të Qendrave për Punë Sociale, mban evidencë për gjendjen e fëmijëve në rrugë të evidentuar dhe merren masa në lidhje me ato. Në rastet kur Qendra për Punë Sociale do të përcaktojë që prindi ka detyruar fëmijën të kërkojë lëmshë ose të përdor për lëmshë, Qendra jep vërejtje, dhe mund të merr vendim për themelimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme për të drejtat dhe obligimet e prindërve. Nëse prindi nuk vepron në përputhje me drejtimit e dhënë nga Qendra për Punë Sociale, fëmija i merret prindit, Qendra nis procedurë për marrjen e të drejtave prindërore para gjykatës kompetente dhe parashtron padi penale kundër prindit.

118. Fëmijët viktimë të trafikimit me qenie njerëzore vendosen në Strehimoren Shtetërore për Viktimë të TQNJ para se të kthehen familjeve të tyre ose të vendosen në familje kujdestare. Fëmijët e huaja mund të vendosen në Shtëpi të Sigurt për kategori të cenuar të migrantëve dhe azilkërkues (shikoni paragrafin 78). Në vitin 2016 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka zbatuar një trajnim të specializuar për kujdestarët për të përforcuar kapacitetet për dhënien e ndihmës fëmijëve viktimë të TQNJ. Trajnimi, i mbështetur nga GIZ, ishte zbatuar në bashkëpunim me Entin për Veprimtari Sociale dhe OJQ "Za Srekno Detstvo".

119. Më tutje, në vitin 2014 Qeveria ka miratuar Programin për Mbështetje të Re-Integrimit të Fëmijëve Viktimë të Trafikimit me Qenie Njerëzore. Programi ka për qëllim të mundësojë një zbatim të gjerë të instrumenteve ligjore, duke siguruar mbështetje sistematike dhe ndihmë nga institucionet meritore, duke lehtësuar qasjen në shërbime, duke mbajtur re-integrimin dhe parandaluar trafikimin sërish të këtyre personave. Programi zbatohet me anë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe stafin e Qendrave për Punë Sociale, në bashkëpunim me OJQ-të. Kjo jep bazën për hartimin e Planeve Individuale për Re-Integrim të fëmijëve viktimë të TQNJ, në të cilat përcaktohen masat, si për viktimën ashtu edhe për anëtarët e familjes së viktimës. Plani Individual për Re-Integrim, që merr parasysh nevojat fizike, psikologjike, psikiatrike, ligjore dhe sociale të fëmijës, hartohet nga një ekip i personave personal të Qendrave për Punë Sociale dhe profesionistëve kompetent të Strehimoreve për Viktimë të TQNJ dhe Qendrës së Pranimi për të Huaj. Planet individuale për re-integrim kanë afat prej së paku një viti. Sipas PSO për veprim me viktimë të TQNJ, një ekip i personave profesional të Qendrës për Punë Sociale bën vlerësim të rrezikut në përputhje me Formularin për Vlerësim të Familjes, që është parashikuar me Programin për Ndihmë dhe Mbështetje të Re-Integrimit dhe Ri-Shoqërimit të Fëmijëve Viktimë të Trafikimit me Qenie Njerëzore. Vlerësimi i familjes bëhet me qëllim të përcaktimit të familjes dhe kapacitetit për të marrë pjesën në re-integrimin dhe ri-shoqërimin. Monitorimi i zbatimit të programit për re-integrim të fëmijës zgjat së paku një ditë, por mund të vazhdojë nëse ekipi i profesionistëve nga Qendra për Punë Sociale konsideron që ajo është e domosdoshme.

120. Në përputhje me Nenin 112 të Ligjit për të Huaj fëmijët e pashoqëruar që nuk mund të jepen organeve kompetente të shtetit të tyre të origjinës duhet të vendosen në Qendrën e Pranimi për të Huaj që është theksuar në paragrafin 110. Sipas personave zyrtar, gjatë periudhës së raportimit, në Qendrën e Pranimi për të Huaj që ka vizituar GRETA nuk ka pasur fëmijë të pashoqëruar. Megjithatë GRETA ishte njoftuar nga ana e përfaqësuesve të OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare me të cilat u zhvilluan takime që fëmijët e pashoqëruar ishin vendosur në këto Qendra gjatë viteve të fundit.⁵⁴ Siç ishte theksuar në raportin e parë të vlerësimit të GRETA, Qendra e Pranimi në fakt paraqet një institucion për paraburgim, dhe jo mjedis i

⁵⁴Në përputhje me raportin e Qeverisë së "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" nga vizita e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Veprimtari Jonjerëzor dhe Poshtërimin ose Dënimit (KST) prej 7 deri 17 tetor 2014, gjatë kohës së vizitës së KST në institucionin kanë qenë të vendosur 265 shtetas të huaj (245 burra dhe 20 gra), përfshirë edhe 29 fëmijë, prej të cilëve 13 kanë qenë të pashoqëruar.

përshtatshëm për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore.⁵⁵GRETA përkujton paragrafin 155 të Memorandumit të Sqaruar ndaj Konventës dhe Nenit 37 (b) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës së OKB, sipas të cilës çdo paraburgim i fëmijëve do të përdoret vetëm si mjet i fundit, edhe atë në periudhën më të shkurtë të mundshme.⁵⁶GRETA thekson që në përputhje me Nenin 12.7 të Konventës, akomodimi i fëmijëve që janë të supozuar si viktima të trafikimit me qenie njerëzore duhet të përshtatet nevojave të tyre specifike.

121. Nëse nuk është e njohura moshja e viktimës, por ka arsye të besohet që ende nuk ka mbushur 18 vite, atëherë nisemi nga supozimi që viktima është fëmijë dhe që duhet të përfitojë nga masat përkatëse për ndihmë deri sa nuk përcaktohet dhe vendosen moshja. Por, mesa duket nuk ka procedurë të standardizuar për vlerësim të moshës. Sipas autoriteteve kombëtare moshja vlerësohet gjatë kohës së intervistës, gjatë së cilës nuk kushtohet vëmendje vetëm indikatorëve fizik, por edhe pjekurinë psikologjike të personit. Personat profesionistë të trajnuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (psikologë dhe punëtorë social), bashkë me nëpunësit policor të Njësisë për Pengimin e TQNJ dhe Kontrabandë të Migrantëve, e marrin në intervistë personit në fjalë për të marrë të dhënat themelore për vendin e origjinës, data dhe vendi i lindjes, prindërit, familja, historia e arsimit dhe dallimi i moshës me vëllezërit dhe motrat. Informacionet për personin kërkohen edhe nga vendet nëpër të cilat supozohet të ketë kaluar para se të arrije në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", duke marrë parasysh mundësinë që më herët ka pasur në posedim dokument të vlefshëm të identifikimit. Kontrolli mjekësor është parashikuar vetëm në raste konkrete.

122. Ndonëse e përshëndet miratimin e Programit për Mbështetje të Re-integrimit të Fëmijëve Viktima të Trafikimit me Qenie Njerëzore, **GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapa plotësues për përmirësimin e identifikimit dhe ndihmën për fëmijët viktima të trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht:**

- **të sigurohet që aktorët meritator të ndërmarrin qasje më pro aktive dhe të zmadhojnë shtrirjen e identifikimit të fëmijëve viktima të TQNJ, duke kushtuar vëmendje veçanërisht fëmijëve në rrugë, fëmijëve rom dhe fëmijët e pashoqëruar;**
- **të sigurohet trajnim plotësues të palëve të interesuara (nëpunës policor, punëtorë social, punëtor shëndetësor dhe kuadro arsimor) si dhe drejtime për identifikim të fëmijëve viktima të TQNJ;**
- **të sigurojnë mbështetje dhe shërbime që do të jenë të përshtatura nevojave të fëmijëve të trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë edhe akomodimin përkatës, qasjes në arsim dhe trajnimi profesional;**
- **në përputhje me interesat më të mira të fëmijëve dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve Refugjatë dhe Migrantë (2017-2019) i Këshillit të Evropës⁵⁷, për të gjetur alternativa për paraburgimin e fëmijëve të pashoqëruar;**
- **të sigurohet monitorimi afatgjatë i re-integrimit të fëmijëve viktima të**

⁵⁵V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 155.

⁵⁶<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CRC.aspx>. Shikoni edhe Strategjia për të Drejtat e Fëmijës 2016-2021 e Këshillit të Evropës dhe Udhëzimet për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve të OKB-së.

⁵⁷Miraturar në seancën e 127 të Komitetit të Ministrave në Nikozia, Qipro, 19 maj 2017.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

trafikimit me qenie njerëzore;

- **të sigurohet zbatim i vlerësimit përkatës të rrezikut para kthimit të fëmijëve tek prindërit e tyre, duke marrë parasysh interesat më të mira të fëmijës.**

ç.Mbrojtja e jetës private (Neni 11)

123. Autoritete Kombëtare kanë theksuar Ligjin për Polici me të cilin nëpunësit policor obligohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacioneve tek të cilat vijnë në kontakt gjatë kohës ose për nevojat e kryerjes së detyrave policore, dhe që janë personale ose të klasifikuara. Obligimi për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacioneve vlen edhe pas ndalimit të marrëdhënies së punës nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Madje edhe më shumë, personat zyrtar përgjegjës për rastet e TQNJ janë të obliguar të ruajnë dhe mbrojnë dokumentet meritorë në përputhje me KP dhe Ligjin për Informacione të Klasifikuara.

124. GRETA ishte e njoftuar që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale mban evidencë për viktimat e TQNJ, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme mban evidencë për kryerësit e veprave penale. Përveç kësaj, Drejtoria e Mbrojtjes së të Dhënave Personale bën monitorimin e përpunimit të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre.

125. PSO për veprim me viktimat e TQNJ përmbajnë edhe formular për deklaratë nga përkthyesit që obligohen të veprojnë në mënyrë konfidenciale me të gjitha informacionet dhe të dhënave e marra gjatë intervistës me viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, dhe pas përfundimit të intervistës, informacionet e marra, mos të keqpërdoren, komentohen ose të zhvlerësohen ndryshe.

d.Periudha e vendimit (Neni 13)

126. Në raportin e saj të parë të vlerësimit, GRETA ka përshëndetur dispozitën nga Ligji për të Huaj për vazhdimin e periudhës së shërbimit dhe mendimit (që në ligjet kombëtare ishte emëruar si "periudha e vlerësimit") për mbi 30 ditët minimale të parashikuar me Konventën, si dhe zbatimi i kësaj periudhe si në viktimat e vendit ashtu edhe ato të huaja të TQNJ. Megjithatë GRETA ka kërkuar nga Autoritetet Kombëtare të sigurohet që kjo periudhë mos të kushtëzohet me bashkëpunimin e viktimës me organet policore dhe mos të ndërpritet kohëzgjatja e kësaj periudhe në bazë të rinovimit të kontakteve të viktimës me trafikantët e dyshuar me persona pa mos marrë parasysh gjendja personale e personit.

127. Nuk janë bërë ndryshime të dispozitave ligjore në lidhje me periudhën e vendimit. Si përkujtim, në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" periudha e vendimit përcaktohet me Nenin 81 të Ligjit për të Huaj, në të cilën, sipas kësaj: "një i huaj për të cilin ka baza dyshimi që është viktimë e veprës penale "trafikim me qenie njerëzore" i mundësohet periudhë e vendimit në kohëzgjatje deri më dy muaj për të mundësuar mbrojtje dhe ndihmë në shërimin dhe shmangien e ndikimit të kryerësve të veprës penale "trafikim me qenie njerëzore"". Gjatë kohës së vendimit, viktima e huaja e TQNJ duhet të pajtohet që të bashkëpunojë me organet kompetente të pushtetit për zbulimin e kryerësve të veprës penale, ose të kthehet në vendin e origjinës ose qëndrim të rregulluar me ligj. Në rast të fëmijëve, duke marrë parasysh interesat e tyre më të mira, periudha mund të vazhdohet. Gjatë kohës së periudhës së vendimit, i huaji nuk guxon të dëbohet nga vendi. Periudha e vendimit mund të ndërpritet nëse i huaji viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, në mënyrë vullnetare, aktive ose me iniciativë personale i rinovon kontaktet me trafikantët e dyshuar ose për shkaqe të rendit publik dhe siguri kombëtare.⁵⁸

128. Siç është theksuar në PSO për veprim me viktimat e TQNJ, si viktimave të huaja ashtu

⁵⁸ V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 158 dhe 159.

edhe atyre vendore ju ofrohet periudhë e vendimit.⁵⁹Në përputhje me statistikën që kanë siguruar Autoritetet Kombëtare, 21 viktimave gra të trafikimit me qenie njerëzore ju është dhënë periudha e vendimit pas vlerësimit të parë të GRETA (në vitin 2013:për 6 gra dhe 5 vajza; në vitin 2014:1 grua dhe 1 vajze; në vitin 2015:për 1 grua dhe 2 vajza; në vitin 2016:2 grave dhe 3 vajzave).Shumica e viktimave kanë qenë nga Serbia, Shqipëria dhe Rumania.

129. Sipas autoriteteve kombëtare, në Ligjin për të Huaj të ri do të inkorporojnë rekomandimet e GRETA-s.**GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare që të revidojnë ligjet me qëllim të sigurimit të periudhës së vendimi të garantuar me Nenin 13 të Konventës të përcaktohet në mënyrë konkrete në ligjin dhe gjitha viktimave të mundshme të trafikimit me qenie njerëzore të ofrohet periudha e vendimit si dhe masa për mbrojtje dhe ndihmë të parashikuar me Nenin 12, Paragrafët 1 dhe 2 të Konventës për afatin e kësaj periudhe.Autoritetet që bëjnë identifikimin duhet të marrin udhëzime të qarta me të cilat do të theksohet nevoja e asaj të ofrohet periudha e vendimit siç është garantuar me Konventën, gjegjësisht të mos kushtëzohet me bashkëpunimin e viktimës, dhe kjo periudhë të ofrohet viktimave para se të japin deklarata formale para hetuesve; më tutje, duhet të përcaktohet procedura për dhënien e periudhës së vendimit.**

dh.Leja për qëndrim (Neni 14)

130. Në raportin e parë të vlerësimit, GRETA ka kërkuar nga Autoritetet Kombëtare të sigurojë që viktimat e TQNJ në mënyrë sistematike të informohen për të drejtën e dhënies së lejes për qëndrim me të drejtë të rinovimit dhe mund të përfitojnë maksimalisht nga kjo mundësi.Përveç kësaj, GRETA ka ftuar Autoritetet Kombëtare të shqyrtojnë mundësinë e dhënies së lejeve për qëndrim viktimave që nuk bashkëpunojnë me organet kompetente të pushtetit.

131. Siç ishte sqaruar në raportin e parë të GRETA, në përputhje me Nenin 82 të Ligjit për të Huaj, pas skadimit të periudhës së vendimit, viktimat e huaja e TQNJ mund të merr leje për qëndrim të përkohshëm sipas kushteve vijuese:qëndrimi i viktimës në vend është i domosdoshëm për të zbatuar procedurën gjyqësore, tregon synim të qartë për bashkëpunim me organet kompetente të pushtetit për zbulimin e veprave penale dhe i ka ndërprerë kontaktet me trafikantët e dyshuar.Leja jepet në periudhë prej minimum gjashtë muaj, që mund të vazhdohet më tutje nëse ende plotësohen kushtet e theksuar më lartë.Leja e përkohshme e qëndrimit mund të tërhiqet nëse viktimat e huaja në mënyrë vullnetare, aktive dhe me iniciativë personale i rinovon kontaktet me trafikantët, për arsye të rendit publik dhe sigurisë kombëtare, nëse viktimat nuk bashkëpunon më me organet kompetente dhe nëse organet kompetente të pushtetit vendosin të ndërpresin procedurën.⁶⁰

132. Sipas statistikës shtetërore, pesë viktimave të trafikimit me qenie njerëzore ju është dhënë leje për qëndrim gjatë periudhës së raportimit (në vitin 2013:3 viktimave; në vitin 2014:2 viktimave).Në vitin 2017, në shtetase të Nigerisë i është dhënë mbrojtje subsidiare, por ajo së

⁵⁹V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 160.

⁶⁰V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 165-167.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

shpejti ka lëshuar "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" (shikoni paragrafin 67).

133. Sipas autoriteteve kombëtare, në Ligjin për të Huaj të ri do të inkorporohen rekomandimet e GRETA-s. GRETA përkujton që me Nenin 14 të Konventës ju lejohet palëve kontraktuese të zgjedhin mes dhënies së lejes për qëndrim për shkak të bashkëpunimit me autoritet ose për shkak të nevojave të viktimës, ose të mundësojnë që lejet të jepen në bazë të dy kriterëve. Ka situata kur viktima ndoshta ka frikë të bashkëpunojnë në hetimin për shkak të kërcënimeve nga trafikantët. Me dhënien e lejes për qëndrim viktimës në bazë të gjendjes personale mundësohet që të merren parasysh shumë situata, siç janë siguria, gjendja shëndetësore dhe gjendje familjare e viktimave, dhe gjithë kjo matet me periudhën e themeluar në të drejta të njeriut në pengimin e TQNJ. **GRETA sërish i fton Autoritetet Kombëtare të shqyrtojnë mundësinë e dhënies së lejes së përkohshme të qëndrimit viktimave të TQNJ në bazë të gjendjes së tyre personale, përveç lejes për qëndrim që jepet në bazë të bashkëpunimit të viktimës me hetimin ose në procedurën gjyqësore.**

134. **Më tutje, GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet të sigurojnë viktimat e huaja të trafikimit me qenie njerëzore që të jenë mirë të informuar për të drejtën e tyre për të marrë leje për qëndrim me të drejtë të rinovimit, duke mos prekur të drejtën për të kërkuar dhe fituar azil.⁶¹**

e. Dëshmërbliimi dhe mjetet ligjore (Neni 15)

135. Në raportin e parë të vlerësimit GRETA ka kërkuar nga Autoritetet Kombëtare të miratojnë masa me të cilat do të mundësohet viktimave të trafikimit me qenie njerëzore të gëzojnë të drejtën e dëshmërbliimit, veçanërisht me anë të themelimit të Programit Shtetëror për Dëshmërbliim që do të jetë në dispozicion të viktimave.

136. Nuk janë bërë ndryshime të dispozitave ligjore në lidhje me dëshmërbliimin që prej raportit të parë të vlerësimit. Viktimat e TQNJ mund të dorëzojnë kërkesë për dëshmërbliim të dëmit material dhe jo-material në çdo fazë të procedurës penale. Gjyqi gjithashtu mund të referojë viktimën që të nis procedurë qytetare për realizimin e të drejtës për dëshmërbliim, por, procedura gjyqësore nuk përdoret shpesh sepse është e shtrenjtë dhe për këtë kryerësi i veprës duhet të jetë në gjykatë. Në përputhje me Ligjin për Procedurë Penale viktima e veprës penale për të cilën është parashikuar dënim me burg prej së paku katër vite ka të drejtë të dëshmërbliimit prej Fondit Shtetëror me kushte dhe mënyra të përcaktuar me ligj të veçantë, nëse dëshmërbliimi nuk mund të sigurohet nga kryerësi. Por, ky ligj nuk është miratuar ende.

137. Autoritetet Kombëtare kanë theksuar që asnjë prej viktimave të TQNJ nuk ka parashtruar kërkesë për dëshmërbliim gjatë periudhës së raportimit. Ka pasur dy aktgjykime në raste të lidhur me TQNJ me të cilat ishte kërkuar sekuestrim të pronës së kryerësit, si dhe katër aktgjykime për sekuestrim të mjeteve për kryerje të veprës penale (shikoni paragrafin 159).

138. Duhet të theksohet programi i miratuar nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2016 në përputhje me Ligjin për Drejtësi Adoleshente për Dëshmërbliim të Fëmijëve Viktima të Trafikimit me Qenie Njerëzore ose fëmijëve të lënduar në vepër të dhunshme penale ose vepra tjera të dhunës individuale ose në grup. GRETA ishte njoftuar që 500.000 denarë ishin dhënë Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij programi. Dëshmërbliimi jepet nga Ministria e Drejtësisë në afat prej 30 ditë nga marrja e vendimit për dëshmërbliim të lëshuar nga gjykata kompetente. Megjithatë, Autoritetet Kombëtare nuk kanë dhënë informacione GRETA-s për numrin e viktimave fëmijë që kanë marrë këtë dëshmërbliim, si dhe për shumën e synuar për dëshmërbliim në buxhetin e vitit 2017.

⁶¹V. UNHCR, Udhëzime për mbrojtje ndërkombëtare: zbatimi i nenit 1A(2) i Konventës së vitit 1951 dhe/ose Protokollit të vitit 1967 për statusin e refugjatëve viktima të trafikimit me qenie njerëzore, HCR/GIP/06/07, 7 prill 2006.

139. Sipas personave zyrtar Qeveria ka për plan të themelojë një Fond Shtetëror për dëmshpërblim të viktimave të veprave të dhunshme kriminale. Në paragrafin 50 vetëm më ishte theksuar raporti i përpiluar nga OJQ "Otvorena Porta / La Strada" në vitin 2016 për mënyrat e themelimit të Fondit Shtetëror për dëmshpërblim të viktimave të veprave të dhunshme penale. Plani Kombëtar i Veprimit 2017-2020 parashikon zbatim të një studimi hulumtues për të përmirësuar qasjen e dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore si dhe të themelohet një grup i punës që do të përpilojë propozim-ligjin mbi fondin për dëmshpërblim të viktimave të veprave të dhunshme penale. Si pjesë e "Aksionit për Parandalimin dhe Pengimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore të Instrumentit Horizontal", më 10 nëntor 2017 në Shkup është zhvilluar një seminar ndërkombëtar për praktikën e mira të themelimit të programeve shtetërore për dëmshpërblim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Qëllimi i seminarit ka qenë të prezantohen modelet e vendeve tjera të programeve shtetërore për dëmshpërblim që janë në dispozicion të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore ose konkretisht të themeluar për këto viktima, dhe të shqyrtohen mënyrat e themelimit të këtij programi shtetëror për dëmshpërblim edhe në vend. Në seminarin përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë kanë nënvizuar vullnetin politik të Ministrisë së përpilohet një mekanizëm efektiv për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Përveç kësaj, ishte hartuar edhe një fletë informative për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion.

140. Viktimat e TQNJ kanë të drejtë për ndihmë juridike falas sipas Ligjit për Ndihmë Juridike Falas.⁶² Ngjashëm me gjendjen nga vlerësimi i parë, GRETA ishte njoftuar që procedura është e ndërlikur dhe që kushtet për marrjen e ndihmës juridike falas është tepër e vështirë për të plotësuar. Si pasojë e kësaj, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore edhe më tutje marrin ndihmë nga avokat i paguar nga OJQ "Otvorena Porta / La Strada".

141. GRETA kërkon sërish nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapa për lehtësim dhe garantim të qasjes efektive për dëmshpërblim të viktimave të TQNJ, veçanërisht:

- të sigurohet që të gjitha viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në mënyrë sistematike të informohen për të drejtën e tyre të dëmshpërblimit dhe për procedurën që duhet të ndjekin;
- të mundësojnë viktimave të TQNJ të realizojnë të drejtën e tyre për dëmshpërblim ashtu që do të garantohet qasje efektive në ndihmë juridike, nëse është e nevojshme edhe me anë të revidimit të procedurës për dhënie të ndihmës juridike, dhe ngritjes së kapaciteteve të juristëve që të mbështesin viktimat në kërkesën e tyre për dëmshpërblim;
- të themelojnë Program Shtetëror për Dëmshpërblim që do të jetë në dispozicion të TQNJ, pavarësisht nga shtetësia e tyre dhe statusi i imigrimit;
- të kyçet dëmshpërblimi i viktimave në programet për trajnim të policëve, prokurorëve, gjykatësve dhe avokatëve.

f. Riatdhesimi dhe kthimi i viktimave (Neni 16)

⁶²V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 152.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

142. Në raportin e parë të vlerësimit GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet të ndërmarrin hapa plotësues për të siguruar që kthimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në shtetin tjetër të zbatohet me respektimin e të drejtave, sigurisë dhe dinjitetit të personit si dhe ndaj statusit të çdo procedure lidhur me faktin që personi është viktimë, si dhe të bëhet në mënyrë vullnetare.

143. Në pajtim me PSO për veprim me viktimat e TQNJ, Zyra e MKR, në bashkëpunim me Njësinë Policore për Pengimin e TQNJ dhe Kontrabandës së Migrantëve dhe OJQ-të është përgjegjëse për kthimin e sigurt të viktimave të TQNJ. Institucionet kompetente janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Punëve të Jashtme, me kyçjen e mundshme të OJQ-ve dhe IOM-it.⁶³

144. Zyra e IOM-it në Shkup edhe më tutje udhëheq me Programin për Kthimin Vullnetar të Ndihtuar dhe Re-integrim të Migrantëve, që është në dispozicion të viktimave të TQNJ. Kthimi i viktimës tërësisht financohet nga IOM-i. Policia kufitare jep ndihmë me qëllim të lehtësimit të procedurës në kalimet kufitare. IOM-i është në komunikim të rregullt me institucionet meritore të përfshirë në procesin e kthimit.

145. Sipas autoriteteve kombëtare, 8 gra viktimat të TQNJ, me origjinë nga Serbia, Shqipëria, Kosova* dhe Rumania ishin riatdhesuar në vendet e tyre të origjinës gjatë periudhës së raportimit (në vitin 2013:5 gra dhe 1 vajzë; në vitin 2014:1 grua; në vitin 2016:1 grua). Në periudhën e njëjtë, 6 gra viktimat ishin riatdhesuar në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" nga vende tjera (në vitin 2013:1 grua dhe 3 vajza; në vitin 2014:1 vajzë; në vitin 2015:1 vajzë) nga Franca, Kroacia, Zvicra dhe Italia.

146. **GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të vazhdojnë me përpjekjet për të siguruar kthimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore të zbatohet me respekt të të drejtave të tyre, sigurisë dhe dinjitetit, të jetë sipas mundësisë në baza vullnetare dhe të jetë në përputhje me obligimin për mos dëbim. Ajo nënkupton që edhe viktimat të informohen për programet aktuale të mbështetjes, si dhe të mbrohen që sërish mos të bëhen viktimat dhe të trafikohen. Duhet tërësisht të merren parasysh udhëzimet e dhënë nga UNHCR për zbatimin e Konventës për Refugjatë mbi personat e trafikuar.**⁶⁴

3. E drejta penale materiale

a. Kriminalizimi i TQNJ (Neni 18)

147. Trafikimi me persona të rritur edhe më tutje kriminalizohet me Nenin 418-a të KP, siç ishte përshkruar në raportin e parë.⁶⁵ Në përputhje me KP të vitit 2015, lista e qëllimeve të eksploatimit të theksuar në Nenin 418-ç të KP në lidhje të trafikimit me fëmijë tani është zgjeruar dhe përfshin eksploatimin për lëmshë dhe eksploatimin për kryerjen e punëve të paligjshme, dhe gjithashtu janë rritur dënimet për rastet kur viktimat është më e vogël se 14 vite. Neni 418-ç i ndryshuar i KP, thotë:

“Neni 418-ç KP – Trafikimi me fëmijë

Ai që do të detyrojë një fëmijë të bëjë marrëdhënie gjinore ose do të mundësojë bërjen e marrëdhënieve gjinore me fëmijë ose detyron, transportin, dërgon, blen, shet ose ofron për shitje, siguron, furnizon, strehon ose pranon fëmijë për shkak të eksploatimit me anë

⁶³V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 178-182.

⁶⁴<http://www.unhcr.org/publ/PUBL/443b626b2.pdf>

⁶⁵V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 14.

të përdorimit për aktivitete seksual” për dëmshpërblim në të holla ose forma tjera të eksploatimit seksual, pornografi, punë të detyruar ose shërbim, lëmshë ose eksploatim për ndonjë aktivitet të ndaluar me ligj, robëri, martesë me dhunë, fertilizim me dhunë, birësim të paligjshëm ose detyrimi i pëlqimit si ndërmjetësues për të birësuar fëmijë, transplantim i palejuar i pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet me burg së paku tetë vite.

(2) Ai që veprën e paragrafit 1 do të bëjë me forcë, kërcënim serioz, me shkaktim të konfuzioni ose formë tjetër të forcës, grabitjes, mashtrimit, keqpërdorim të pozitës ose gjendjes së shtatzënisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mendore të tjetrit, ose me dhënien ose pranimin e të hollave ose dobi tjetër për marrjen e pëlqimit nga personi që ka kontroll mbi personin tjetër, ose vepër e bërë ndaj një fëmije që nuk ka mbushur 14 vjeç, do të dënohet me burg së paku dhjetë vite.

(3) Ai që përdor ose mundëson përdorim nga tjetri për shërbime seksuale ose lloj tjetër eksploatimi të fëmijës për të cilin ka ditur ose ka pasur për detyrë të dije që është viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, do të dënohet me burg prej së paku tetë vite.

(4) Përdoruesi i shërbimeve seksuale nga fëmijë që nuk ka mbushur 14 vjeç, do të dënohet me burg prej së paku 12 vite.

(5) Ai që do të merr ose shkatërrojë letërnjoftim, pasaportë ose dokument tjetër identifikimi për shkak të kryerjes së veprave të theksuar në paragrafët 1 dhe 2, do të dënohet me burg së paku katër vite.

(6) Nëse vepra nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni zhvillohet nga person zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, do të dënohet me burg prej së paku dhjetë vite.

(7) Pëlqimi i fëmijës me veprimet e theksuar në paragrafin 1, nuk është me rëndësi për ekzistimin e veprës penale nga paragrafi 1.

(8) Nëse vepra nga ky nen kryhet nga person juridik, do të dënohet me gjobë në të holla.

(9) Pronat e patundura të përdorura dhe gjërat dhe mjetet e transportit që janë përdorur për veprën do të sekuestrohen.”⁶⁶

148. Në raportin e parë të vlerësimit GRETA ka ftuar Autoritetet Kombëtare të sigurojnë që gjitha rrethanat e vështirësimit të theksuar në Konventën në mënyrë përkatëse të merren parasysh dhe gjitha veprimet e theksuar në Nenin 20 të Konventës të përcaktohen si vepra penale. Si përgjigje të këtyre rekomandimeve, Autoritetet Kombëtare theksuan që analizat juridike janë në zbatim e sipër. **GRETA dëshiron të njoftohet për rezultatin.**

149. Me Nenin 418-b të KP, me titullin “Kontrabanda e Migrantëve”, kriminalizohet vepra që paraqet kombinim i mjeteve dhe veprimeve të ngjashme me ato të lidhura me trafikimin me qenie njerëzore, me dallimin e vetëm që mundon elementi i eksploatimit. GRETA ka vërejtur në raportin e parë që ndonëse ekziston kjo vepër penale bashkë me veprën penale të TQNJ në Nenin 418-a të KP sërish mund të shkaktojë numër të vogël të viktimave formale të identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore dhe ka ftuar Autoritetet Kombëtare të analizojnë lidhjen mes neneve 418-a dhe 418-b të KP, në kuptim të sqarimit të shtrirjes së zbatimit të këtyre dy dispozitave. Sipas

⁶⁶Përkthim jozyrtar.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

informacioneve të GRETA, ky rishqyrtim ende nuk është zhvilluar. Autoritetet Kombëtare kanë theksuar që Plani Ndër Resor për Trajnim të Pengimit të TQNJ (shikoni paragrafin 32) nënkupton trajnim për gjithë aktorët e përfshirë (nëpunës policor, gjykatës, prokurorë publik, inspektorë të punës, punëtorë social dhe tjerë) në lidhje me dallimet mes këtyre dy veprave penale. Në komentet për propozim-raportin e GRETA, Autoritetet Kombëtare kanë deklaruar që numri i zvogëluar i viktimave të identifikuar të TQNJ nuk ndodh për shkak të konfuzionit mes neneve 418-a dhe 418-b të KP, por për shkak të shkurtimit të personelit përkatëse që kryesisht është marrë me TQNJ, zvogëlimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të Njësisë për Pengimin e TQNJ dhe Kontrabandën e Migrantëve, si dhe angazhimi i pamjaftueshëm i inspektorëve të punës, punëtorëve shëndetësor, kuadrit mësimor dhe punëtorët social. **GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të ndërmarrin hapa plotësuese për të siguruar që profesionistët meritë mirë të kuptojnë dallimin mes trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandën e migrantëve.**

b. Kriminalizimi i përdorimit të shërbimeve nga viktima (Neni 19)

150. Siç ishte sqaruar në raportin e parë të vlerësimit, përdorimi i vetëdijshëm i shërbimeve nga viktimat e trafikimit me qenie njerëzore kriminalizohet me Nenin 418-a, paragrafi 3 i KP (në lidhje me të rritur) dhe Nenin 418-ç, paragrafi 3 i KP (në lidhje me fëmijë). Autoritetet kanë theksuar që në vitin 2014 ka pasur katër aktgjykime për përdorim të shërbimeve nga viktima të trafikimit me qenie njerëzore. **GRETA përshëndet përdorimin praktik të kriminalizimit të përdorimit të shërbimeve nga viktima të trafikimit me qenie njerëzore dhe fton autoritetet të vazhdojnë me promovimin e zbatimit përkatës.**

c. Përgjegjësia e personit juridik (Neni 22)

151. Përgjegjësia penale e personit juridik përcaktohet me Nenin 418-a paragrafi 6 i KP (për trafikimin me persona të rritur) dhe Neni 418-ç paragrafi 8 i KP (për trafikimin me fëmijë). Dënimi i parashikuar është në të holla. Më tutje, në përputhje me Nenin 96-a dhe 96-b të KP, gjykatat mund të shqiptojnë edhe dënime tjera për personat juridik, përfshirë edhe ndalesë të përkohshme ose përhershme të kryerjes së veprimtarisë së caktuar, madje edhe ndërprerje të punës.⁶⁷ **GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të monitorojnë zbatimin e dispozitave të përgjegjësive penale të personit juridik në rastet e TQNJ në drejtim të sigurimit të zbatimit të tyre efektiv në praktikë.**

ç. Mos dënimi i viktimave të TQNJ (Neni 26)

152. Në kohën e vlerësimit të parë nuk ka pasur asnjë dispozitë konkrete të ligjeve kombëtare me të cilën garantohet viktimave të TQNJ që nuk do të jenë të dënuar për përfshirjen e tyre në aktivitete të paligjshme, me kusht që mos të kenë qenë të detyruar për atë. GRETA do të kërkojë nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin masave ligjore me të cilat do të mundësohet viktimave të TQNJ të mos jepen dënime për përfshirjen e tyre në aktivitete të paligjshme, me kusht që të kenë qenë të detyruar për atë, dhe të japin udhëzime për prokurorët dhe organet gjyqësore për zbatimin e dispozitave për mos dënimin e viktimave të TQNJ.

153. GRETA ishte njoftuar që në periudhën prej 2013 deri 2016 nuk ka pasur raste të denoncuar të akuzimit ose ndjekjes së personave të trafikuar për aktivitete të paligjshme për të cilët kanë qenë të detyruar të kryejnë. Në vitin 2014 Komisioni Kombëtar, në bashkëpunim me shoqërinë

⁶⁷V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 190.

qytetare dhe me mbështetjen e Misionit të OSBE në Shkup, ka zbatuar një analizë të zbatimit të dispozitës për mos dënim në ligjet vendore dhe praktikës juridike. Analiza ka dhënë rekomandime konkrete për përputhje të ligjeve kombëtare dhe praktika me standardet ndërkombëtare. Në vitin 2015 është zhvilluar një tribunë mes palëve meritorë të interesuara, në të cilën ishin prezantuar dhe shqyrtuar pohimet dhe rekomandimet nga kjo analizë. Në qershor 2016 Komisioni Kombëtar ka zhvilluar punëtori për palët e ndryshme të interesuara, në të cilën, mes tjerash, ishte diskutuar edhe për zbatimin e parimit të mos dënimit.

154. Gjatë vizitës së dytë të vlerësimit personat zyrtar e njoftuan GRETA për planin për ligjin për të inkorporuar dispozitën për mos dënim. Në iniciativë të Komisionit Kombëtar, ekspert vendor ka përgatitur propozim-amendamente për inkorporim të dispozitës së mos dënimit në Kodin Penal. Autoritetet kanë deklaruar, pas miratimit të propozimit, do të fillojë me ndryshimin e KP.

155. GRETA i përshëndet hapat që janë marrë nga vizita e parë për analizë të zbatimit të dispozitës për mos dënim dhe promovim të mëtutjeshëm të zbatimit në praktikë. **Megjithatë, GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin masa plotësuese për të siguruar respektimin e parimit të mos dënimit të viktimave të TQNJ për përfshirjen e tyre në aktivitete të paligjshme, me kusht që mos të kenë qenë të detyruar, siç është theksuar në Nenin 26 të Konventës. Këto masa duhet të përfshijnë edhe miratimin e dispozitës konkrete ligjore dhe/ose hartimin e udhëtimit për nëpunësit policor dhe prokurorët për shtrirjen e dispozitës për mos dënim, përfshirë edhe në kuptim të dënimit në procedura administrative/qytetare.** Në këtë kontekst duhet të theksohen rekomandimet për mos dënim të synuar për ligjbërësit dhe prokurorët, të dhënë në dokumentin e lëshuar nga Zyra e Përfaqësuesit Special dhe Koordinator për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të OSBE, në konsultim me Ekipin Profesional Konsultues të Aleancës për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore.⁶⁸

4. Hetimi, ndjekja dhe e drejta procesuale

a. Masa lidhur me sigurimin e hetimit efektiv (Nenet 1, 27 dhe 29)

156. Në raportin e parë të vlerësimit, ndonëse ka përshëndetur përpjekjet e policisë dhe prokurorisë për pengimin e TQNJ në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet edhe më tutje të përvetësojnë specializimin dhe trajnimin e prokurorëve dhe gjykatësve në drejtim të ndjekjes efektive të veprave penale lidhur me TQNJ.

157. Siç ishte përshkruar në raportin e parë, hetimi penal për TQNJ me detyrë zyrtare e nis Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsion. Hetimi i rasteve të TQNJ i jepet njësisë së specializuar policore për pengimin e TQNJ dhe kontrabandës së migrantëve, që punon në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin për Krim Financiar. Gjatë kohës së vizitës së GRETA në këtë njësi kanë punuar shtatë nëpunës policor, që është katër më

⁶⁸<http://www.osce.org/cthb/101002>

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

pak nga koha e vlerësimit të parë të GRETA.⁶⁹ Personat zyrtar kanë theksuar nevojën për staf më të gjerë për të mundur në mënyrë efektive të kryhen detyrat. Gjykata Themelore Shkupi 1 edhe më tutje është gjykata e vetme në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" që është kompetente për rastet e TQNJ.⁷⁰

158. Masat e veçanta hetimore janë të rregulluar me nenet 252-256 të Ligjit për Procedurë Penale dhe këtu bëjnë pjesë, mes tjerash, monitorimi i komunikimeve, ndjekja sekrete dhe incizimi i personave, si dhe përdorimi i personave me identitet të fshehur.⁷¹ Më tutje, monitorimi i komunikimeve rregulloret edhe me Ligjin për Ndjekjen e Komunikimeve, me të cilin, me tjerash, rregullohet procedura, mënyra e marrjes, ruajtjes dhe përdorimit të të dhënave me anë të ndjekjes së komunikimeve.

159. Veprat penale lidhur me TQNJ që bëhen me anë të internetit kriminalizohen me Nenet 193 (Shfaqja e materialeve pornografike të fëmijës) dhe 193-a (Prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë fëmijërore) nga KP.Ministria e Punëve të Brendshme ka krijuar aplikacionin "Butoni i Kuq" për denoncimin e veprave penale, përfshirë edhe pornografi fëmijërore dhe keqpërdorim të fëmijëve. Informacione për dyshim të veprës penale mund të dorëzohen edhe me anë të postës elektronike deri në Sektorin për Krim Kompjuterik dhe Forenzikë Digjitale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Për të zbuluar veprat penale në fushën e pornografisë fëmijërore, Sektori për Krim Kompjuterik dhe Forenzikë Digjitale zhvillon një hetim pro aktiv në internet, veçanërisht në rrejtët sociale, për të zbuluar kryerësit, vendet që bëhet shkëmbimi i fotografive dhe materialeve me keqpërdorim të fëmijëve, si dhe rastet e keqpërdorimit të fëmijëve.

160. Sipas statistikave të siguruar nga Autoritetet Kombëtare në periudhën 2013-2016 ishin nisur 10 hetime për raste të TQNJ (në vitin 2013:1 hetim; në vitin 2014:3 hetime; në vitin 2015:3 hetime; në vitin 2016:3 hetime). Në vitin 2013 ka pasur 3 aktgjykime për TQNJ, 1 në vitin 2014, 5 në 2015 dhe 1 në vitin 2016, gjatë së cilave dënimet kanë qenë prej 4 deri më 10 vite. Në hetimin që është zhvilluar në vitin 2014 për 8 nëpunës policor ka pasur pohime që kanë qenë të përfshirë në TQNJ. Departamenti për Kontroll të Brendshëm dhe standardet profesionale kundër tyre kanë nisur procedura disiplinore. Kundër gjithë këtyre nëpunësve policor ishin shqiptuar padi penale, prej të cilëve shtatë ishin mbajtur, dhe më vonë të akuzuar dhe gjykuar me disa vite burg.

161. Me 2 aktgjykime ishte kërkuar sekuestrimi i pronës së përfituar në mënyrë të paligjshme (në vitin 2015) ndërsa me 4 aktgjykime ishte kërkuar sekuestrimi i mjeteve për kryerjen e veprës penale (3 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2014). Sipas Prokurorisë Publike gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur ndjekje penale për TQNJ për detyrim pune.

162. GRETA ka vërejtur që 5 kryerës kanë qenë të dënuar me kusht, që duket se është në kundërshtim me masat minimale penale të përcaktuar me Nenet 418-a dhe 418-c të KP. Autoritetet Kombëtare kanë theksuar që me Nenin 40 të KP lejohet që gjykata të shqiptojë dënim më të ultë nga dënimi i parashikuar me ligj nëse ka rrethana zbutëse me të cilët arsyetohet ulja e dënimit.

163. GRETA më mënyrë të shqetësuar vëren që numri i aktgjykimeve për TQNJ është relativisht i ultë. Nëse ishte vërejtur që me arritjen e numrit të lartë të migrantëve janë shpenzuar pjesa më e madhe e resurseve në dispozicion, personat zyrtar me të cilët ishte zhvilluar takim gjatë kohës së vizitës në vend, kanë treguar që policia duhet të ndërmerret një qasje më pro aktive në pengimin e TQNJ. Në komentet për propozim-raportin e GRETA-s Autoritetet Kombëtare kanë theksuar që ishin zhvilluar dy punëtori dyditëshe më 13-14 shtator 2017 në Shkup, me qëllim të vlerësimit të përvojës nga Serbia për themelimin e grupit operativ për pengimin e kontrabandës së migrantëve dhe TQNJ. Themelimi i një grupi të ngjashëm operativ në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" me titullin "Njësia Kombëtare për Pengimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Kontrabandën e Migrantëve" dhe është parashikuar me Planin e Veprimit dhe Strategjisë për 2017-2020. Ajo do të përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përfshirë edhe anëtarë të Departamentit për Krim Financiar dhe Departamentit për Pengimin e Krimin të

⁶⁹V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 29.

⁷⁰V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 31 dhe 32.

⁷¹V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafi 199.

Organizuar dhe Serioz, si dhe prokurorë të Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsion. Autoritetet besojnë që në këtë mënyrë do të kontribuohet për pengimin më efikas të trafikimit me qenie njerëzore dhe migracionin e paligjshëm me anë të komunikimit me kohë mes organeve kompetente të pushtetit. Ishte bërë edhe një analizë e mungesave të zbatimit të hetimeve financiare. Deri në fund të vitit 2017 do të duhet të fillojë me punë grupi ndër resor i punës për hartimin e propozim Strategjisë Kombëtare për Përforcimin e Kapaciteteve për zbatimin e hetimeve financiare dhe sekuestrimin e pronës.

164. GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmerren masa plotësuese me të cilat do të sigurohet që rastet e TQNJ të hetohen në mënyrë pro aktive, të ndiqen me sukses dhe të rezultojnë me dënim efektiv, të gjerë dhe bindëse, veçanërisht:

- të identifikohen mungesat e hetimit dhe ndjekjes së rasteve të TQNJ;
- të sigurohen mjete përkatëse dhe staf të mjaftueshëm për punën hetimore të policisë;
- të sensibilizohen hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit për të drejtat e viktimave të TQNJ dhe si plotësim të përvetësojnë specializimin e tyre për përballimin me rastet e TQNJ dhe të zbatojnë dispozitat me të cilat kriminalizohet TQNJ.

165. Më tutje, duke përkujtuar obligimin e palëve kontraktuese të Konventës për të sekuestruar pronën e përfituar në mënyrë të paligjshme lidhur me trafikimin e me qenie njerëzore, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përforcojnë përpjekjet e tyre për identifikim, marrje dhe sekuestrim të pronës së përfituar në mënyrë të paligjshme nga veprat të lidhura me trafikimin me qenie njerëzore.

b. Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave (Neni 28)

166. Në raportin e parë të vlerësimit GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet tërësisht të shfrytëzojnë masat në dispozicion për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve të TQNJ.


167. Siç ishte sqaruar në raportin e parë të GRETA, në përputhje me Ligjin për Procedurë Penale, viktimat kanë të drejtë për masat të posaçme të mbrojtjes procesuale. Viktimat e TQNJ kanë të drejtë të merren në intervistë duke përdorur mjete audio-vizuale dhe të kërkojnë përjashtim të publikut nga debati kryesor. Më tutje, me Ligjin për Mbrojtje të Viktimave mundësohet përfshirje të viktimave në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, dhe ka një Njësi të veçantë për mbrojtje të dëshmitarëve. Masa të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve në procedura penale janë përcaktuar me Ligjin e Drejtësisë Adoleshente, si dhe me Ligjin për Procedurë Penale, gjatë së cilës me ligjin e dytë mundësohet edhe marrje në pyetje me anë të video konferencës.⁷²

168. Autoritetet Kombëtare kanë theksuar që masat e veçanta për mbrojtje në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve janë zbatuar për viktimat e TQNJ gjatë periudhës së raportimit. Sipas informacioneve që janë siguruar nga OJQ-të⁷³, masat e posaçme për mbrojtjen e

⁷²V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 205 dhe 206.

⁷³Otvorena Porta / La Strada, Monitorimi dhe vlerësimi i ligjeve dhe politikave për luftë kundër trafikimit me qenie

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



viktimave/dëshmitarëve ishin zbatuar si brenda ashtu edhe jashtë gjykatave në tre raste gjatë vitit 2015.

169. **GREТА konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet tërësisht të përdoren masat aktuale dhe të mbrojnë viktimat dhe dëshmitarët e TQNJ nga hakmarrja potenciale ose frikësimi para, gjatë kohës ose pas procedurës penale.**

c. Juridiksioni (Neni 31)

170. Me Nenin 116, Paragrafit 1 të KP përcaktohet juridiksioni mbi secilin që do të bëjë vepër penale në territorin e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë". Me Nenin 116, Paragrafin 2 dhe 3 të KP ky juridiksion zgjerohet edhe në vepra penale të kryera në anije vendore ose në hapësirë ajrore vendore. KP thotë që ligjet penale vlejné edhe për shtetasit e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" që do të bëjnë vepër penale jashtë territorit të vendit, por që do të kapen në territorin e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" ose të ekstradohen në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë". Më tutje, KP vlen edhe për kryerësin që nuk është shtetas i "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" nëse kanë bërë vepër penale kundër shtetasve të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" jashtë territorit të vendit dhe kapet në territorin e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë". Ligjet penale vlejné edhe për personat që nuk janë shtetas të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" dhe që do të bëjë vepër penale kundër shtetasit të huaj jashtë vendit, me kusht që ligji në vendin që është bërë vepra penale të përcaktojë dënim me burg prej së paku pesë vite, nëse kryerësi kapet në territorin e "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" dhe nuk ekstradohet në vendin e huaj.

171. Sipas autoriteteve, ligjet kombëtare lejojnë që viktimat e huaja të paraqet padi në vendin e origjinës nëse vepra penale ka qenë e zhvilluar në "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë". Në periudhë prej 2013-2016 ishte vërejtur një rast i viktimës së huaj të TQNJ, nga Shqipëria, ku padia ishte parashtrua në vendin e origjinës së viktimës.

5. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me shoqërinë qytetare

a. Bashkëpunimi ndërkombëtar (Nenet 32 dhe 33)

172. Bashkëpunimi me vendet tjera për pengimin e TQNJ bazohet në Ligjin për Ndihmë Juridike për Materie Penale, Ligjin për Procedurë Penale, marrëveshjet që ka firmosur vendi dhe marrëveshjet tjera meritore bilaterale.⁷⁴

173. Autoritetet Kombëtare kanë theksuar disa iniciativa të fundit për bashkëpunim për parandalimin e TQNJ dhe migracionit të paligjshëm:

- Memorandum i Mirëkuptimit me qeveritë e Serbisë, Austrisë dhe Hungarisë për parandalimin e rrjedhave të përziera të migracionit, të firmosur në Ohër më 4 shtator 2015;
- Deklarata e miratuar në Konferencën e Nivelit të Lartë për rrugët e Mesdheut Juglindor dhe Ballkanit Perëndimor (Luksemburg, 8 tetor 2018);
- Deklaratë e liderëve e miratuar në Takimin e Liderëve të Shefave të Shteteve ose Qeverive e dedikuar krizës me refugjatë (Bruksel, 25 tetor 2015);

njerëzore dhe zbatimi i tyre në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" në vitin 2014 dhe 2015, 2016, f. 21.

⁷⁴Për më tepër detaje, shikoni Raporti i parë i GREТА, paragrafët 93-98 dhe lista e marrëveshjeve bilaterale të Aneksit 17 të Përgjigjes së "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" për Pyetësin e GREТА për raundin e 2-të të vlerësimit.

- Deklarata e përbashkët e miratuar në Konferencën Ministrore në Forumin e Salsburgut (Sofje, 18-19 nëntor 2015)

174. Negociatat për nënshkrimin e protokollit për bashkëpunim në fushën e pengimit të TQNJ mes "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" dhe Kosovës* kanë përfunduar në nëntor të vitit 2017. Më tutje, Komisioni Kombëtar ka filluar iniciativa për nënshkrimin e një protokollit të ngjashëm edhe me Malin e Zi, ndërsa në fund të tetorit 2017 ishte zhvilluar takime në të cilin ishte shqyrtuar propozim-teksti.

175. "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" është palë kontraktuese e Konventës për Bashkëpunim Policor në Evropën Juglindore. Në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me të cilin parashikohet themelimi i Ekipeve të Përbashkëta Hetimore, ishte zhvilluar edhe punësoria e katër në temën "Përdorimi i ekipeve të përbashkëta hetimore për pengimin e trafikimit me qenie për Ballkanin Perëndimor" më 8-10 korrik 2014 në Shkup. Ishin zhvilluar edhe dy punëtori në temën e njëjtë në Serbi dhe Mal të Zi. Por, "Ish Republika Jugosllave a Maqedonisë" nuk ka marrë pjesën në asnjë Ekip të Përbashkët Hetimor të themeluar për rastet e TQNJ.

176. "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim me Eurojust, por ka vendosur të mos ketë Prokuror për lidhje me Eurojust, dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë takim koordinator për TQNJ në periudhën 2012-2017.

177. Autoritetet Kombëtare kanë theksuar për pjesëmarrjen e tyre në disa aktivitete për bashkëpunim ndërkombëtar lidhur me pengimin e TQBJ gjatë periudhës raportuese.⁷⁵ Komisioni kombëtar ka organizuar punëtori rajonale në qershor 2016 në Shkup dedikuar pengimit të TQNJ dhe migracionit të paligjshëm. Më 27-28 tetor 2016, OSBE ka organizuar në Shkup një konferencë rajonale në temën "Përmirësimi i bashkëpunimit dhe qasjes së përbashkët në përballimin e TQNJ nëpër rrugën e migracionit në Ballkanin Perëndimor". Përveç kësaj, në vitin 2015 ishte zhvilluar një tryezë e rrumbullakët dyditore në temën "Zbulimi dhe ndjekja e veprës penale TQNJ për shkak të eksploatimit për punë" në të cilën gjykatësit, prokurorët dhe nëpunësit policor të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" ju ishte dhënë mundësi të shkëmbejnë shqyrtimet dhe përvojat me kolegët nga prokuroria e Bosnjës dhe Hercegovinës. Në dhjetor të vitit 2015 tre përfaqësues të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" kanë marrë pjesën në punëtori të organizuar nga Këshilli i Evropës për "Promovimin e mbrojtjes së të drejtave të viktimave të TQNJ" në Budva, Mal të Zi, me fokus mbi qasjen në dëmshpërblim për viktimave e TQNJ dhe dispozita e mos dënimit.

178. Në lidhje me masat e lidhura me fëmijët e zhdukur, Autoritetet Kombëtare kanë theksuar që në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" ende nuk ka funksionuar numri i përshtatur i telefonit për fëmijë të zhdukur.

179. GRETA ka theksuar që gjendja me refugjatët dhe migrantë vetëm ka rritur rëndësinë më shumë për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacioneve për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore.⁷⁶ **GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të vazhdojnë dhe të**

⁷⁵Për më tepër detaje, shikoni përgjigjen e pyetjes 56 të Përgjigjeve të "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" për Pyetësorin e GRETA për raundin e 2-të të vlerësimit dhe Raporti i dorëzuar nga autoritetet kombëtare për masat e ndërmarra për përputhje me Rekomandimin CP(2014)13 për zbatimin e Konventës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Komitetit të Palëve Kontraktuese.

⁷⁶Shikoni edhe Dokumentin e punës së stafit të Komisionit Evropian, 2015, Raporti për "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", si aneks i dokumentit "Deklaratë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian, dhe Komitetin e Rajoneve", f. 62.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

përforcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në drejtim të parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore, ndihmën për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore si dhe hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore.

180. **Më tutje, GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të përforcojnë bashkëpunimet ndërkombëtare për të lehtësuar hetimin për persona të rrezikuar ose zhdukur, veçanërisht fëmijë të zhdukur.**

b. Bashkëpunimi me shoqërinë qytetare (Neni 35)

181. Shoqëria qytetare edhe më tutje luajnë rol kryesor në veprimin për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore në "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë". OJQ "Otvorena Porta / La Strada", "Za Srekno Detstvo", iniciativa qytetare për mundësi të barabartë "Semper" dhe "Ednakov Pristap" dhe më tutje në mënyrë aktive janë të angazhuar në fushën e pengimit të trafikimit me qenie njerëzore. Siç ishte vërejtur në paragrafin 19, OJQ-të marrin pjesë edhe në Komisioni Kombëtar nëpërmjet Sekretariatit dhe Nën-Grupit për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore.⁷⁷

182. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka firmosur një Memorandum Bashkëpunimi me OJQ "Otvorena Porta / La Strada" dhe "Za Srekno Detsvto" me të cilat këto OJQ sigurojnë ndihmë juridike, shëndetësore dhe psikologjike viktimave të vendosur në Strehimoren Shtetërore (shikoni paragrafin 108).

183. Gjatë kohës së vizitës së vendit nga ana e personave zyrtar të GRETA edhe përfaqësuesit e shoqërisë qytetare e kanë theksuar bashkëpunimin e tyre në fushën e pengimit të trafikimit me qenie njerëzore. Megjithatë GRETA me shqetësim kanë vërejtur që mjetet shtetërore për punë të OJQ-ve në fushën e pengimit të trafikimit me qenie njerëzore dukshëm janë zvogëluar gjatë periudhës raportuese (shikoni paragrafin 107). Përveç kësaj, me kalimin e kohës është zvogëluar edhe shumica e mjeteve të huaja që janë në dispozicion OJQ-ve, me çfarë financimi nga shteti bëhet më e rëndësishme për zbatimin e masave për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore.

184. **Ndonëse e përshëndet bashkëpunimin e mirë mes shtetit dhe shoqërisë qytetare, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të sigurojnë mjete përkatëse për OJQ-të e specializuar dhe që janë aktive në fushën e pengimit të trafikimit me qenie njerëzore, duke marrë parasysh rolin e tyre të rëndësishëm në pengimin e TQNJ. Më tutje, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë me ndërtimin e partneriteteve strategjike me shoqërinë qytetare, përfshirë edhe me sindikatat dhe sektorin privat, në drejtim të arritjes së qëllimeve të Konventës.**

⁷⁷V. Raporti i parë i GRETA-s, paragrafët 25 dhe 33.

IV.Konkluzione

185. Nga miratimi i raportit të parë të GRETA-s për "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" në vitin 2013, në shumë fusha të ndryshme ishte vazhduar të arrihet përparim.

186. Autoritetet Kombëtare kanë ndryshuar dispozitën e Kodit penale që ka të bëjë me trafikimin me fëmijë, dhe nga ana tjetër propozim-ligji i ri i Ligjit për të Huaj, që përmban dispozitë për periudhën e vendimi dhe dhënies së lejeve për qëndrim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore është në proces të miratimit.

187. Korniza institucionale për veprim kundër trafikimit me qenie njerëzore gjithashtu ka arritur evolucion.Me qëllimin për të përshtatur qëndrimin ndaj trendëve të rinj të trafikimit me qenie njerëzore, Komisioni Kombëtar për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore u zgjerua me shtimin e përfaqësuesve të Agjencisë së Punësimit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës.Më tutje, janë themeluar tre Komisione Lokale të reja për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore, që gjithsej kanë arritur numrin pesë.

188. Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar i Veprimit për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe migracionit të paligjshëm të miratuar në vitin 2017 i pasqyrojnë trendët dhe nevojat e reja.

189. GRETA i përshëndet hulumtimet e bërë për aspektet e ndryshme të TQNJ, përfshirë edhe zbatimin e dispozitës së mos dënimit, trafikimit me fëmijë dhe prezantimi i Programit Shtetëror për Dëmshpërblim.

190. Janë bërë përpjekje për të vazhduar me trajnimin e profesionistëve meritore dhe të zgjerohen kategoritë e stafit që trajnohet.Miratimi i Planit Ndër Resor për trajnim është një risi e mirëseardhur.Trajnimet zbatohen në bashkëpunim me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare dhe sipas mundësisë promovohet qasje e përfshirjes së gjithë palëve të interesuara.

191. Të përballuar me rritjen e numrit të migrantëve dhe kërkuesve të azilit në vitin 2015-2016, Autoritetet Kombëtare kanë hartuar "Indikatorët për Identifikim të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Rrjedhat e Përziera të Migracionit" dhe të profesionistëve meritore ju është dhënë trajnime për avancimin e identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit me qenie njerëzore në mesin e azilkërkuesve dhe migrantëve.Risi tjera të mirëseardhura janë edhe miratimi i Procedurave Standarde Operative për veprim me kategori të cenuar të shtetasve të huaj dhe Procedurat Operative Standarde për veprim me fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, në bashkëpunim me UNHCR.

192. Në fushën e parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore autoritetet kanë zbatuar shumë aktivitete për ngritjen e vetëdijes, në partneritet me organizatat ndërkombëtare dhe OJQ.Një vëmendje e posaçme është dedikuar ngritjes së vetëdijes për rreziqet e trafikimit me fëmijë dhe krijimit të mjedisit mbrojtës për fëmijët, përfshirë edhe me anë të masave për përballim me cenueshmërinë specifike të fëmijëve në rrugë.

193. Në mesin e risive tjera pozitive është edhe zbatimi praktik i kriminalizimit të përdorimit të shërbimeve nga viktimat e trafikimit me qenie njerëzore dhe hapat e ndërmarrë për analizim të zbatimit të dispozitës për mos dënim dhe promovimit të mëtutjeshëm të zbatimit në praktikë.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

194. Janë bërë edhe përpjekje në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar juridik për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë edhe nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim me Eurojust.

195. Megjithatë, ndonëse ka përparim të arritur, disa çështje janë për shqetësim. Në këtë raport, GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin veprime plotësuese në shumë fusha tjera. Vendi i rekomandimeve nëpër tekstin e këtij raporti është shënuar në kllapa.

Cështje të cilat kërkojnë veprim urgjent

- **GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapat plotësuese për të siguruar që gjitha viktimat të trafikimit me qenie njerëzore të identifikohen në mënyrë përkatëse dhe të mund të përfitojnë nga masat për ndihmë dhe mbrojtje të garantuar me Konventën, veçanërisht:**
 - të promovohen qasje ndër resorëve në identifikimin e viktimave, me anë të formalizmit të rolit dhe kontributit të OJQ-ve të specializuara;
 - të sigurohen resurset e nevojshme njerëzore dhe financiare me të cilat do të mundësohet nëpunësve policor, punëtorëve social, OJQ-ve dhe aktorëve tjerë meritore të zbatojnë një qasje më pro aktive dhe të rrisin shtrirjen e tyre në identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;
 - të zmadhohen përpjekjet për identifikim pro aktiv të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore për shkak të eksploatimit për punë me an të përforcimit të rolit dhe trajnimit të inspektorëve të punës, dhe sigurimi i veglave dhe resurseve për Inspektoratin Shtetëror të Punës që janë të nevojshme për ndalimin efektiv dhe pengimin e TQNJ;
 - të kushtohet më tepër vëmendje për zbulimin e viktimave potenciale të trafikimit me qenie njerëzore mes migrantëve dhe azilkërkuesve dhe të sigurohet qasje për interpretim për të lehtësuar gjithë procesin (paragrafi 105);
- **GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapa për përmirësimin e ndihmës për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, veçanërisht:**
 - të sigurohen resurse përkatëse financiare dhe njerëzore për ndihmë të viktimave të supozuar dhe formalisht të identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë edhe me anë të dhënies së mandatit të OJQ-ve të specializuara të ofrojnë ndihmë;
 - të sigurohen mjete përkatëse për ndihmë, përfshirë edhe akomodim, për viktimat e supozuar dhe formalisht të identifikuar të TQNJ;
 - të përforcojnë mbështetjen për re-integrim të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në shoqëri, me anë të ofrimit të trajnimit profesional, ndihmë për gjetjen e punës dhe dhënies së resurseve përkatëse për shërbimet që ndihmojnë viktimave për re-integrimin e tyre.
 - të sigurohet strehim përkatës për viktimat e huaja të vendosen në Strehimoren Shtetërore menjëherë pasi që të zbulohet arsyeja themelore dhe të besohet që janë viktimat të trafikimit me qenie njerëzore (paragrafi 115).
- **GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapa për përmirësimin e identifikimit dhe ndihmës për fëmijët viktimat të trafikimit me qenie njerëzore,**

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

veçanërisht:

- të sigurohet që aktorët meritor të ndërmarrin qasje më pro aktive dhe të zmadhojnë shtrirjen e identifikimit të fëmijëve viktime të TQNJ, duke kushtuar vëmendje veçanërisht fëmijëve në rrugë, fëmijëve rom dhe fëmijët e pashoqëruar;
 - të sigurohet trajnim plotësues të palëve të interesuara (nëpunës policor, punëtorë social, punëtor shëndetësor dhe kuadro arsimor) si dhe drejtime për identifikim të fëmijëve viktime të TQNJ;
 - të sigurojnë mbështetje dhe shërbime që do të jenë të përshtatura nevojave të fëmijëve të trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë edhe akomodimin përkatës, qasjes në arsim dhe trajnimi profesional;
 - në përputhje me interesat më të mira të fëmijës dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve Refugjatë dhe Migrantë (2017-2019) i Këshillit të Evropës, për të gjetur alternativa për paraburgimin e fëmijëve të pashoqëruar;
 - të sigurohet monitorimi afatgjatë i re-integrimit të fëmijëve viktime të trafikimit me qenie njerëzore;
 - të sigurohet zbatim i vlerësimit përkatës të rrezikut para kthimit të fëmijëve tek prindërit e tyre, duke marrë parasysh interesat më të mira të fëmijës (paragrafi 122);
- GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare që të revidojnë ligjet me qëllim të sigurimit të periudhës së vendimi të garantuar me Nenin 13 të Konventës të përcaktohet në mënyrë konkrete në ligjin dhe gjitha viktimave të mundshme të trafikimit me qenie njerëzore të ofrohet periudha e vendimit si dhe masa për mbrojtje dhe ndihmë të parashikuar me Nenin 12, Paragrafët 1 dhe 2 të Konventës për afatin e kësaj periudhe. Autoritetet që bëjnë identifikimin duhet të marrin udhëzime të qarta me të cilat do të theksohet nevoja e asaj të ofrohet periudha e vendimit siç është garantuar me Konventën, gjegjësisht të mos kushtëzohet me bashkëpunimin e viktimës, dhe kjo periudhë të ofrohet viktimave para se të japin deklarata formale para hetuesve; më tutje, duhet të përcaktohet procedura për dhënien e periudhës së vendimit (paragrafi 129).
- GRETA kërkon sërish nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapa për lehtësim dhe garantim të qasjes efektive për dëmshpërblim të viktimave të TQNJ, veçanërisht:
- të sigurohet që të gjitha viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në mënyrë sistematike të informohen për të drejtën e tyre të dëmshpërblimit dhe për procedurën që duhet të ndjekin;
 - të mundësojnë viktimave të TQNJ të realizojnë të drejtën e tyre për dëmshpërblim ashtu që do të garantohet qasje efektive në ndihmë juridike, nëse është e nevojshme edhe me anë të revidimit të procedurës për dhënie të ndihmës juridike, dhe ngritjes së kapaciteteve të juristëve që të mbështesin viktimat në kërkesën e tyre për dëmshpërblim;
 - të themelojnë Program Shtetëror për Dëmshpërblim që do të jetë në dispozicion të TQNJ, pavarësisht nga shtetësia e tyre dhe statusi i imigrimit;
 - të kyçet dëmshpërblimi i viktimave në programet për trajnim të policëve, prokurorëve, gjykatësve dhe avokatëve (paragrafi 141);
- GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin masa plotësuese për

të siguruar respektimin e parimit të mos dënimit të viktimave të TQNJ për përfshirjen e tyre në aktivitete të paligjshme, me kusht që mos të kenë qenë të detyruar, siç është theksuar në Nenin 26 të Konventës.(paragrafi 155)GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmerren masa plotësuese me të cilat do të sigurohet që rastet e TQNJ të hetohen në mënyrë pro aktive, të ndiqen me sukses dhe të rezultojnë me dënim efektiv, të gjerë dhe bindëse, veçanërisht:

- të identifikohen mungesat e hetimit dhe ndjekjes së rasteve të TQNJ;
- të sigurohen mjete përkatëse dhe staf të mjaftueshëm për punën hetimore të policisë;
- të sensibilizohen hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit për të drejtat e viktimave të TQNJ dhe si plotësim të përvetësojnë specializimin e tyre për përballimin me rastet e TQNJ dhe të zbatojnë dispozitat me të cilat kriminalizohet TQNJ (paragrafi 164).

Konkluzione plotësuese

- GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të hapin një post të posaçëm Koordinator Kombëtar, që do të ketë në dispozicion resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, për të mundësuar në mënyrë efektive të zbatojë detyrat e mandatit përkatës (paragrafi 20).
- GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të bazohen në Njoftues Kombëtar të pavarur ose të emërojnë mekanizëm tjetër si subjekt të pavarur organizativ në drejtim të sigurimit të monitorimit efektiv të aktiviteteve të institucioneve shtetërore në lidhje pengimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe dhënien e rekomandimeve për palët dhe institucionet e interesuara (paragrafi 23).
- GRETA i fton Autoritetet Kombëtare që angazhojnë Zyrën e Avokatit të Popullit në zbatimin e aktiviteteve për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe në hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit në përmasa kombëtare (paragrafi 26).
- Duke përkujtuar rekomandimin që ka dhënë në raportin e parë të vlerësimit, GRETA konsideron që autoritetet duhet të ndajnë mjete specifike nga buxheti i shtetit për veprim kundër TQNJ, me anë të konsultimit të gjithë aktorëve meritor, ndërsa duke pasqyruar nevojat e vërteta të një qasje të koordinuar dhe efektiv të bazuar në të drejta të njeriut për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore (paragrafi 26).
- GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të vazhdojnë me ngritjen e vetëdijes mes profesionistëve dhe mes opinionit të gjerë në lidhje me përcaktimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe për dallimet, por edhe lidhjet, mes trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës së migrantëve (paragrafi 30).
- GRETA konsideron që autoritetet duhet të përforcojnë punën e Komisioneve Lokale për Luftë kundër TQNJ, përfshirë edhe me anë të sigurimit të mjeteve specifike për aktivitetet e tyre (paragrafi 31).
- GRETA ka përshëndetur përpjekjet për trajnim të profesionistëve meritor në temën e

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

- TQNJ dhe konsideron që këto përpjekje duhet në mënyrë sistematike të vazhdojnë dhe të përforcojnë, gjatë së cilës vëmendje të posaçme duhet kushtuar trajnimit të inspektorëve të punës, stafit mjekësor dhe profesionistë tjerë për të cilët ka mundësi që të vijnë në prekje me viktimat për trafikim me qenie njerëzore, përfshirë edhe fëmijët. Më tutje, GRETA i fton Autoritetet Kombëtare që në intervale të rregullta të vlerësojnë rëndësinë, efektin dhe shtrirjen e aktiviteteve për trajnim (paragrafi 43).
- Për nevojat e përgatitjes, monitorimi dhe vlerësimi i politikave për pengimin e trafikimit me qenie njerëzore, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përpilojnë dhe mirëmbajnë një sistem të gjerë dhe të përputhur statistikor për trafikim me qenie njerëzore me anë të mbledhjes së të dhënave të besueshme statistikore për viktimat e supozuar dhe identifikuar të trafikimit me qenie njerëzore dhe masat për mbrojtje dhe avancim të të drejtave të tyre, si dhe për hulumtimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore. Statistikat për viktimat duhet të mblidhen nga gjithë aktorët kryesor dhe duhet të mundësohet shpërndarje e tyre sipas gjinisë, moshës, llojit të eksploatimit, shtetit të origjinës dhe/ose destinacionit. Kjo duhet të plotësohet me gjitha masat e nevojshme me të cilat do të sigurohet e drejta e subjekteve të të dhënave për të mbrojtur të dhënat personale, përfshirë edhe kur OJQ-ve që punojnë me viktimat e trafikimit me qenie njerëzore do të kërkohet të jepen informacione për nevojat e bazës kombëtare me të dhëna.
 - GRETA përshëndet gjitha përpjekjet hulumtuese të autoriteteve kombëtare dhe konsideron që duhet të vazhdohet me zbatimin dhe mbështetjen e hulumtimeve për çështje lidhur me TQNJ, dhe gjatë kësaj duke kushtuar vëmendje të madhe të TQNJ për shkak të eksploatimit me punë, trafikim me qenie njerëzore dhe trafikim të brendshëm të qenieve njerëzore (paragrafi 52).
 - GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë me zbatimin e fushatave informative dhe fushatave për ngritjen e vetëdijes për TQNJ. Masat e ardhshme për ngritjen e vetëdijes duhet të planifikohen në mënyrë që do të merren parasysh vlerësimet e ndikimit të masave paraprake, duke u fokusuar mbi nevojat e identifikuara dhe grupet e synimit dhe duke përfshirë vëmendjen e ndryshimeve të reja ligjore dhe trendët e reja. Duhet posaçërisht të kushtohet vëmendje mbi ngritjen e vetëdijes për TQNJ për shkak të eksploatimit për punë, lëmosha me forcë, martesë me dhunë, bërja e veprave kriminale me dhunë dhe trafikim i brendshëm i qenieve njerëzore (paragrafi 55).
 - GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të zmadhojnë përpjekjet e tyre për parandalim të TQNJ për shkak të eksploatimit për punë, veçanërisht:
 - të vazhdojnë me ngritjen e vetëdijes së rreziqeve nga trafikimi me qenie njerëzore për shkak të eksploatimit për punë si në vend ashtu edhe jashtë vendit;
 - të trajnojnë dhe sensibilizojnë personat zyrtarë meritore, veçanërisht inspektorët e punës, prokurorët dhe gjykatësit për TQNJ për shkak të eksploatimit për punë dhe për të drejtat e viktimave;
 - të zgjerojnë mandatin e inspektorëve të punës në mënyrë që të përfshijnë edhe subjektet afariste të përgjithshme dhe shtëpitë private dhe të jepen resurse dhe drejtime që të mund në mënyrë aktive të angazhohen në parandalimin e TQNJ;
 - të prezantojnë licencim dhe monitorim të agjencive për punësim të përhershëm ose përkohshëm;
 - të angazhohen edhe sindikatat në sektorin privat, në përputhje me Parimet Prijëse për Afarizëm dhe të Drejta të Njeriut (paragrafi 60).
 - GRETA kërkon nga Autoritetet Kombëtare të ndërmarrin hapa me të cilat do të sigurohet regjistrim i gjithë fëmijëve gjatë lindjes (paragrafi 73);
 - GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përforcojnë përpjekjet e tyre në

- fushën e parandalimit të trafikimit me fëmijë, duke përdorur rezultatet e hulumtimeve për trendët e reja, me anë të përforcimit të kapaciteteve dhe resurseve të profesionistëve që punojnë në mbrojtjen e fëmijëve, ngritjen e vetëdijes për trafikim me fëmijë dhe manifestimet e ndryshme (përfshirë edhe lëmshën e dhunuar, hyrje në martesë dhe kryerja e veprave kriminele) dhe sigurim të mjedisit mbrojtës për fëmijët në rrugë dhe fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë (paragrafi 74);
- Ndonëse i njeh masat që merren për të përfshirë cenueshmërinë e refugjatëve dhe migrantëve për TQNJ, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përforcijnë përpjekjet në këtë fushë dhe të vazhdojnë me ndërmarrjen e hapave për ulje të cenueshmërisë së personave që takojnë komunitetit rom, veçanërisht grave dhe fëmijëve, drejt trafikimit me qenie njerëzore, me anë të masave sociale, ekonomike dhe tjera. Duhet të bëhen edhe përpjekje plotësuese për promovimin e barazisë gjinore, pengimin e dhunës së bazuar në gjini dhe stereotipat, dhe mbështetje për politika konkrete të fuqizimit të grave si mjet për pengimin e shkaktarit kryesor të TQNJ (paragrafi 81);
 - GRETA konsideron që punëtorët shëndetësor të përfshirë në transplantimin e organeve dhe profesionistët tjerë meritohet të sensibilizohen për TQNJ për shkak të marrjes së organeve me anë të trajnimeve dhe dhënieve të udhëzimeve (paragrafi 86).
 - GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për frenim të kërkesës së shërbimeve të personave të trafikuar, me anë të miratimit të masave ligjore, administrative, arsimore, sociale dhe kulturore për frenimin e kërkesës që nxit çfarëdo forme të eksploatimit që shpie drejt trafikimit me qenie njerëzore, në partneritet me shoqërinë qytetare, sindikatat dhe sektorin privat (paragrafi 92);
 - GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të përfshijnë këtë personel në Planin Ndër Resor për Trajnim (paragrafi 96);
 - Ndonëse përshëndet përpilimin e Indikatorëve për Identifikim të Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Rrjedha të Përziera të Migracionit, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë me përpjekjet për zbulimin dhe viktimitave potenciale në kalimet kufitare dhe të sigurojnë shërbimeve meritore trajnime me të cilat do të aftësohen për zbulimin e hershëm dhe referim të viktimitave të mundshme të TQNJ të grupeve të cenuar, siç janë migrantë dhe azilkërkues, përfshirë edhe fëmijë të pashoqëruar dhe të ndarë (paragrafi 97);
 - GRETA i fton Autoritetet Kombëtare që të sigurohet se POS për veprim me viktimat e TQNJ të revidohen rregullisht që të jenë në hap me trendët e reja të TQNJ (paragrafi 99);
 - GRETA sërish i fton Autoritetet Kombëtare të shqyrtojnë mundësinë e dhënies së lejes së përkohshme të qëndrimit viktimitave të TQNJ në bazë të gjendjes së tyre personale, përveç lejes për qëndrim që jepet në bazë të bashkëpunimit të viktimitës me hetimin ose në procedurën gjyqësore (paragrafi 133);
 - Më tutje, GRETA ka konsideruar që Autoritetet Kombëtare duhet të sigurojnë viktimat e huaja të trafikimit me qenie njerëzore që të jenë mirë të informuar për të drejtën e tyre për të marrë leje për qëndrim me të drejtë të rinovimit, duke mos prekur të drejtën për të kërkuar dhe fituar azil (paragrafi 134);

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

- GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të vazhdojnë me përpjekjet për të siguruar kthimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore të zbatohet me respekt të të drejtave të tyre, sigurisë dhe dinjitetit, të jetë sipas mundësisë në baza vullnetare dhe të jetë në përputhje me obligimin për mos dëbim. Ajo nënkupton që edhe viktimat të informohen për programet aktuale të mbështetjes, si dhe të mbrohen që sërish mos të bëhen viktima dhe të trafikohen. Duhet tërësisht të merren parasysh udhëzimet e dhënë nga UNHCR për zbatimin e Konventës për Refugjatë mbi personat e trafikuar (paragrafi 146);
- GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të ndërmarrin hapa plotësuese për të siguruar që profesionistët meritor mirë të kuptojnë dallimin mes trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandën e migrantëve (paragrafi 149);
- GRETA përshëndet përdorimin praktik të kriminalizimit të përdorimit të shërbimeve nga viktima të trafikimit me qenie njerëzore dhe fton autoritetet të vazhdojnë me promovimin e zbatimit përkatës (paragrafi 150)
- GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të monitorojnë zbatimin e dispozitave të përgjegjësisë penale të personit juridik në rastet e TQNJ në drejtim të sigurimit të zbatimit të tyre efektiv në praktikë (paragrafi 151);
- GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet tërësisht të përdoren masat aktuale dhe të mbrojnë viktimat dhe dëshmitarët e TQNJ nga hakmarrja potenciale ose frikësimi para, gjatë kohës ose pas procedurës penale (paragrafi 169);
- GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të vazhdojnë dhe të përforcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në drejtim të parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore, ndihmën për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore si dhe hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore (paragrafi 179);
- GRETA i fton Autoritetet Kombëtare të përforcojnë bashkëpunimet ndërkombëtare për të lehtësuar hetimin për persona të rrezikuar ose zhdukur, veçanërisht fëmijë të zhdukur (paragrafi 180);
- GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të sigurojnë mjete përkatëse për OJQ-të e specializuar dhe që janë aktive në fushën e pengimit të trafikimit me qenie njerëzore, duke marrë parasysh rolin e tyre të rëndësishëm në pengimin e TQNJ. Më tutje, GRETA konsideron që Autoritetet Kombëtare duhet të vazhdojnë me ndërtimin e partneriteteve strategjike me shoqërinë qytetare, përfshirë edhe me sindikatat dhe sektorin privat, në drejtim të arritjes së qëllimeve të Konventës (paragrafi 184).

Anekse

Lista e organeve shtetërore, organizata ndërqeveritare, organizata joqeveritare dhe aktorë tjerë të shoqërisë qytetare me të cilët GRETA ka zhvilluar konsultime

Organe shtetërore

- Ministria e Punëve të Brendshme
 - Koordinatori Kombëtar për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm
 - Njoftuesi Kombëtar për Trafikim me Qenie Njerëzore
 - Njësia për Pengimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Kontrabandë të Migrantëve
 - Sektori për Punë Kufitare dhe Migracione
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
 - Zyra e Mekanizmit Kombëtar për Referim
 - Nën-Grupi për Luftë kundër Trafikimit me Fëmijë
 - Qendra për Punë Sociale
 - Inspektorati Shtetëror i Punës
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Shëndetësisë
- Prokuroria Publike
- Gjykata Themelore Shkupi 1
- Avokati i Popullit
- Komisione Lokale për Luftë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migracion të Paligjshëm në Manastir, Shtip, Veles dhe Prilep

Organizata ndërqeveritare

- Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikës së Migracionit (ICMPD)
- Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM)
- Komisarati i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara (UNHCR)
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)
- Fondi Fëmijëror i Kombeve të Bashkuara (UNICEF)

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

OJO dhe organizata tjera të shoqërisë qytetare

- Iniciativa Qytetare për Mundësi të Barabarta Semper
- Za Srekno Detstvo
- Otvorena Porta / La Strada


Komente nga Qeveria

GRETA ka nisur dialog me Autoritetet Kombëtare pas propozimit të parë të raportit. Komentet e dhënë nga shumë organe të pushtetit ishin marrë parasysh dhe ishin integruar në versionin e fundit të raportit.

Konventa kërkon që "raporti dhe konkluzionet nga GRETA të publikohen menjëherë pas miratimit, bashkë me komentet eventuale nga palët kontraktuese". GRETA ka dorëzuar raportin përfundimtar tek Autoritetet Kombëtare më 21 dhjetor 2017 dhe ka ftuar që të parashtrijnë komentet përfundimtare. Me shkresë nga 16 dhjetori 2018 (e dhënë më poshtë), Autoritetet Kombëtare kanë theksuar që nuk shohin nevojë që të parashtrijnë komente në lidhje me raportin përfundimtar të GRETA-s.

Publikimi është hartuar me ndihmën e mjeteve të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Përmbajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet që pasqyron shqyrtimet zyrtare të Bashkimit Evropian.

Zyra e Këshillit të Evropës në Shkup  <http://horizontal-facility-eu.coe.int>

Qendra afariste Soravia  horizontal.facility@coe.int

Filip vtori Makedonski nr. 3 1000 Shkup  [jp.horizontal.facility@CoE_EU_HF](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility@CoE_EU_HF)

tel.: +389 2 3100-330  [@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)


ALB

Këshilli i Evropës është organizatë udhëheqëse për të drejtat e njeriut në kontinent. Ajo përfshin 47 vende anëtare, prej të cilave 28 janë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, marrëveshje qëllimi i së cilës është mbrojtja e të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe të sundimit të së drejtës. Gjykata evropiane për të drejta të njeriut e mbikëqyr zbatimin e Konventës nga.

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur që të lidhin njohuritë, resurset dhe fatet e tyre. Bashkërisht, ata kanë krijuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, dhe gjatë kësaj duke mbajtur llojllojshmërinë kulturore, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është dedikuar për ndarjen e arritjeve dhe vlerave të saja me shtetet dhe popujt jashtë kufijve të saj.

www.coe.int

<http://europa.eu>



GRUPI G R E T A
I EKSPERTËVE PËR VEPRIM
KUNDËR TRAFIKIMIT ME
QENIE NJERËZORE

**Sekretariati i Konventës së Këshillit të Evropës
për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore**
(GRETA dhe Komiteti i Palëve të Kontraktuara)

Këshilli i Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
Francë

Council of Europe
F-67075 Strasbourg Cedex
France

trafficking@coe.int
www.coe.int/en/web/anti-human-trafficking

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe